REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO /
KOMUNA SHTIME/ OPSTINA-STIMLJE/ MUNICIPALITY OF SHTIME
ZYRA E KRYETARIT/KANCELARIJA PREDSEDNIKA/MAYOR'S OFFICE
Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim
OpštinskaKancelarijaza Zajednice i Povratak
Municipality Office for Comunitiesand Returnies

# PLANI LOKAL I VEPRIMIT PËR PËR AVANCIMIN E TË DREJTAVE TË KOMUNITETEVE ROM DHE ASHKALI NË KOMUNËN E SHTIMES 2024-2026

**Mars 2024**

Nr.01-060/01-17774/23 datë: 08.10.2023

Npi – 01/154 datë: 08.10.2023

Duke u bazuar në nenin 53 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040; Si dhe bazuar në Strategjinë e Qeverisë së Republikës së Kosovës për përfshirjen e komuniteteve Rom dhe Ashkali në shoqërinë Kosovare 2024-2026; Kuvendi i Komunës së Shtimes, në mbledhjen e mbajtur më: Data , Aprovoi:

# PLANIN LOKAL TË VEPRIMIT PËR PËRFSHIRJEN E KOMUNITETEVE ROM DHE ASHKALI NË KOMUNËN E SHTIMES 2022-2026

PËRMBAJTJA:


SHKURTESAT ..... 3

1. HYRJE ..... 4

   1.1. Metodologjia ..... 4

2. ANALIZA E GJENDJES ..... 5

   2.1. Arsimi ..... 5

   2.2. Punësimi dhe mirëqenia sociale ..... 8

   2.3. Shëndetësia ..... 9

   2.4. Banimi ..... 10

3. OBJEKTIVAT DHE AKTIVITETET ..... 12

   3.1. Arsimi ..... 14

      3.1.1. Sfidat kryesore ..... 14

      3.1.2. Rezultatet e pritshme ..... 14

      3.1.3. Përshkrimi i aktiviteteve ..... 15

      3.1.4. Supozimet dhe rreziqet ..... 17

   3.2. Punësimi dhe mirëqenia sociale ..... 17

      3.2.1. Sfidat kryesore ..... 17

      3.2.2. Rezultatet e pritshme ..... 18

      3.2.3. Përshkrimi i aktiviteteve ..... 18

      3.2.4. Supozimet dhe rreziqet ..... 20

   3.3. Shëndetësia ..... 20

      3.3.1. Sfidat kryesore ..... 20

      3.3.2. Rezultatet e pritshme ..... 21

3.3.3. Përshkrimi i aktiviteteve....................21
3.3.4. Supozimet dhe rreziqet....................22
**3.4. Banimi**....................23
3.4.1. Sfidat kryesore....................23
3.4.2. Rezultatet e pritshme....................23
3.4.3. Përshkrimi i aktiviteteve....................23
3.4.4. Supozimet dhe rreziqet....................25
4. BUXHETI....................25
5. PLANI I ZBATIMIT....................26
SHTOJCA 1....................38
GRUPI PUNUES....................38

SHKURTESAT

| | |
|---|---|
| **ASK** | Agjencia e Statistikave të Kosovës |
| **DKA** | Drejtoria Komunale e Arsimit |
| **DKRS** | Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport |
| **DSHMS** | Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale |
| **IP** | Institucionet Parashkollore |
| **MAShT** | Ministria e Arsimit, Shkencës dhe e Teknologjisë |
| **MSh** | Ministria e Shëndetësisë |
| **OJQ** | Organizata Joqeveritare |
| **OSHC** | Organizatat e Shoqërisë Civile |
| **PLV** | Plani Lokal i Veprimit |
| **PRTAN** | Ekipet për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes |
| **QKMF** | Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare |
| **QKUK** | Qendra Klinike Universitare e Kosovës |
| **QM** | Qendra Mësimore |
| **QMF** | Qendra e Mjekësisë Familjare |
| **QPS** | Qendra për Punë Sociale |
| **SMIA** | Sistemi i Menaxhimit të Informatave në Arsim |
| **SWOT** | Sukseset, Dobësitë, Mundësitë dhe Rreziqet |
| **ZKKK** | Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim |
| **ZQM** | Zyra për Qeverisje të Mirë |

## 1. HYRJE

Në vitin 2022, Zyra për Qeverisje të Mirë (ZQM/ZKM) në Zyrën e Kryeministrit ndërmori iniciativën për hartimin e Strategjisë së re për përfshirjen e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në shoqërinë kosovare. Pas një procesi të gjatë gjithëpërfshirës dhe konsultimesh me të gjithë akterët, në prill të vitit 2022, është aprovuar STRATEGJIA PËR AVANCIMIN E TË DREJTAVE TË KOMUNITETEVE ROM DHE ASHKALI NË REPUBLIKËN E KOSOVËS 2022-2026 DHE PLANI I VEPRIMIT 2022-2024.

Strategjia për Avancimin e të Drejtave të Komuniteteve Rom dhe Ashkali në Republiken e Kosovës 2022-2026 dhe Plani i veprimit 2022-2024 paraqet një vazhdimësi të politikave të Qeverisë së Republikës së Kosovës për ndërtimin e një shoqërie shumetnike dhe krijimin e një shteti të qytetarëve të barabartë, i cili do të garantojë të drejtat e secilit qytetar, liritë qytetare dhe barazinë e të gjithë qytetarëve. Në bazë të Kornizës BE-së për Integrimin e Romëve, janë definuar pesë fusha të veprimit të cilat adresohen në Strategji: arsimi, punësimi dhe mirëqenia sociale, shëndetësia, banimi dhe diskriminimi. Këto fusha paraqesin prioritetet me të cilat duhet të ballafaqohet zbatimi i Strategjisë, dhe ndërveprojnë me njëra tjetrën. Në shumicën e rasteve paraqesin edhe shkaqe edhe rrjedhoja apo efekte të njëra-tjetrës, prandaj është jetike të punohet në secilën në mënyrë që të arrihen rezultate efektive. Për secilën nga pesë fushat e Strategjisë është definuar një objektiv strategjik. Secili objektiv strategjik është zbërthyer në objektiva specifike, ndërsa këto objektiva specifike më tutje në Planin e Veprimit janë zbërthyer në rezultate dhe në aktivitete.

Për realizimin e këtij Plani Lokal të Veprimit, Komuna e Shtimes ka themeluar grupin punues për hartimin e planit të veprimit.

### 1.1. Metodologjia

Pas themelimit te grupit punues janë zhvilluar disa takime konsultative dhe dy punëtori. Më poshtë do të paraqesim ecurinë e procesit si dhe një përshkrim të metodologjisë së punës për hartimin e Planit Lokal të Veprimit për Avancimin e të Drejtave të Komuniteteve Rom dhe Ashkali në Komunen e Shtimes 2024-2026.

Grupi punues ka zhvilluar një seri të takimeve me përfaqësuesit e Komunës, me qëllim të mbledhjes së informatave relevante që do të ndihmojnë në hartimin e Planit. Pas takimeve konsultative është zhvilluar punëtoria e parë me grupin punues të caktuar nga Komuna për të prezantuar të dhënat e gjetura dhe për të përcaktuar fushëveprimin e Planit.

Meqenëse STRATEGJIA PËR AVANCIMIN E TË DREJTAVE TË KOMUNITETEVE ROM DHE ASHKALI NË REPUBLIKËN E KOSOVËS 2022-2026 DHE PLANI I VEPRIMIT 2022-2024, në nivel qendror, i ka identifikuar 5 fusha kryesore, atëherë edhe grupi punues ka vendosur që Planit Lokal ti Veprimit për Avancimin e të Drejtave të Komuniteteve Rom dhe Ashkali në Komunen e Shtimes 2024-2026 të ketë këto pesë fusha kryesore:

1. Arsimi
2. Punësimi dhe mirëqenia sociale
3. Shëndetësia
4. Banimi
5. Diskriminimi

Për secilën nga pesë fushat e Strategjisë është definuar një objektiv strategjik. Secili objektiv strategjik është zbërthyer në objektiva specifike, ndërsa këto objektiva specifike më tutje janë zbërthyer në rezultate dhe në aktivitete.

Pas përcaktimit të fushave të veprimit, është zhvilluar një punëtori dy ditore një takim me grupin e gjerë, për të analizuar gjendjen ekzistuese. Për të arritur objektivat e kësaj punëtorie është përdorur analiza SWOT, ku gjatë 4 sesioneve është bërë analiza e gjendjes nga secila fushë e përcaktuar nga Plani i Veprimit. Kontributet e nxjerra nga analiza SWOT janë përmbledhur në tabela specifike për secilën fushë dhe janë shfrytëzuar si udhërrëfyes për përshkrimin e gjendjes aktuale. Gjatë punëtorisë është bërë validimi i të gjeturave nga analiza e gjendjes dhe pastaj janë përcaktuar objektivat strategjike, rezultatet dhe aktivitetet përkatëse dhe është bërë finalizimi i Planit të veprimit dhe përcaktimit të kostos buxhetore për zbatimin e tij.

## 2. ANALIZA E GJENDJES

Takimi për hartimin e Planit të Veprimit ka pasur për qëllim analizën e gjendjes së komuniteteve rom dhe ashkali në komunën e Shtimes në këto 5 fusha: Arsimi , Punësimi dhe Mirëqenia sociale, Shëndetësia, Banimi dhe Diskriminimi

Sipas statistikave të regjistrimit të vitit 2011, në komunën e Shtimes jetojnë 750 pjesëtarë të të komunitetit Ashkali dhe 23 të komunitetit Rom. Mirëpo, sipas statistikave të ZKKK-së, në komunën e Shtimes jetojnë 1038 qytetarë të komunitetit ashkali dhe romë, në Shtime 750, në Gjyrkoc 200, në Vojnovc 64 dhe në Davidovc 24 qytetarë të komunitetit ashkali.

Në nivelin e arsimit parafillor janë 17 nxënës, prej tyre 9 femra dhe 8 meshkuj. Në nivelin e arsimit fillor dhe të mesëm të ulët në Komunën e Shtimes ndjekin mësimet 179 nxënës, prej tyre 72 femra dhe 60 meshkuj. Ndërsa në arsimin e mesëm të lartë janë 34 nxënës, prej tyre 22 femra dhe 12 meshkuj.

Numri i familjeve që janë në asistencë sociale nga Komuna e Shtimes është 43 familje të komunitetit Ashkali, kurse nga komunitetit Rom nuk ka asnjë familje në asistencë sociale.

Siç shihet nga statistikat e sipërpërmendura, në Komunën e Shtimes, pjestarët e komunitetit Ashkali, përbëjnë numrin më të madh të pakicave. Komuniteti Ashkali dhe në përgjithësi komunitetet në këtë komunë nuk janë mjaft mirë të përfshira në institucionet lokale të qeverisjes.

Në organogramin e komunës, nuk ka të përfshirë nënkryetar apo ndonjë person tjetër të punësuar dhe as në Zyren Komunale për Komunitete dhe Kthim apo në drejtori të tjera, përveç një e punësuar si Zyrtare e Gjendjes Civile. Megjithatë, Komiteti për Komunitete përfaqësohet nga tre pjesëtarë të komunitetit Ashkali dhe një pjeëstarë nga komuniteti Rom.

Më poshtë do të paraqesim të gjeturat nga secila fushë.

### 2.1. Arsimi

Në Komunën e Shtimes përfshirja e fëmijëve/nxënësve të komuniteteve rom dhe ashkali në të gjitha nivelet e edukimit/arsimit parauniversitar mbetet në nivel jo të kënaqshëm.

Sipas statistikave zyrtare nga MASHT/SMIA dhe Agjencia e Statistikave të Kosovës në vitin shkollor 2022-2023 dhe 2023-2024 nuk ka pasur asnjë nxënës nga komuniteti Ashkali dhe Rom të përfshirë në edukimin parashkollor në komunën e Shtimes, përderisa numri i përgjithshëm i nxënësve të përfshirë është 197.

Sikurse edhe në disa komuna të tjera, ekziston një shpërputhje e të dhënave nga niveli lokal, përkatësisht nga ZKKK dhe ato nga niveli qendror MASHT/SMIA. Po ashtu, komuna e Shtimes nuk ka të dhëna se sa është numri i nxënësve të komuniteteve Ashkali dhe Rom që nuk janë të përfshirë në secilin nga nivelet e edukimit/arsimit parauniversitar, prandaj dhe është e pamundur që të konstatohet me saktësi për nivelin e përfshirjes.

Sikurse edhe në disa komuna të tjera, funksionimi i Qendrave Mësimore (QM) ka ndihmuar mjaft shumë në përfshirjen e fëmijëve të komuniteteve Ashkali dhe Rom në sistemin e arsimit, përmes përkrahjes në fusha të ndryshme. Një qendër e tillë funksionon edhe në komunën e Shtimes, përkatësisht në SHFMU "Emin Duraku", në Shtime, ku numri është 66 nxënës. Edhe pse kanë funksionuar dy qendrat mësimore në SHFMU "Lasgush Poradeci" në Gjyrkoc dhe në Vojnoc, tani nuk janë duke funksionuar në mungesë të një zgjidhjes adekuate për financimin e tyre nga komuna e Shtimes.

Në arsimin e detyruar, pra në shkollimin fillor dhe të mesëm të ulët (klasa 1-9), në komunën e Shtimes jan të përfshirë gjithsej 149 nxënës, prej tyre 147 të komunitetit Ashkali dhe 2 të komunitetit Rom. Ndërsa në shkollimin e mesëm të lartë të përfshirë janë 30 nxënës, prej tyre 29 të komunitetit Ashkali dhe 1 i komunitetit Rom.

Është me rëndësi të përmendet që përveç faktorëve të tjerë, përfshirjes së ulët të fëmijëve/nxënësve të komuniteteve rom dhe ashkali në të gjitha nivelet e edukimit/arsimit parauniversitar në Komunën e Shtimes i kontribuon edhe gjendja e rëndë sociale-ekonomike e familjeve të këtyre komuniteteve.

Përveç nivelit jo të kënaqshëm të përfshirjes së fëmijëve/nxënësve të komuniteteve rom, dhe ashkali në të gjitha nivelet e edukimit/arsimit parauniversitar, shqetësim tjetër konsiderohet edhe suksesi jo i mirë i nxënësve të këtyre komuniteteve krahasuar me mesataren e suksesit të përgjithshëm të nxënësve të komunitetit shumicë, megjithëse për këtë nuk ka statistika të sakta zyrtare.

Fenomeni i braktisjes së shkollimit nga nxënësit e komuniteteve Ashkali dhe Rom, në komunën e Shtimes nuk është prezent në shifra shqetësuese, posaqërisht në arsimin e detyruar. Gjithnjë duke u bazuar në të dhënat e DKA-së gjatë vitit shkollorë 2022/2023, në komunën e Shtimes, asnjë nxënës nuk e ka braktisur shkollimin. Gjatë hartimit të planit është kuptuar nga pjesëmarrësit se në shumë shkolla jan themeluar ekipet për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes (PRTAN), mirëpo mbetet ende për t'u bërë më shumë në drejtim të funksionalizimit të tyre në të gjitha shkollat.

Analiza SWOT e zhvilluar gjatë puntorisë nxjerr në pah edhe shumë faktorë të tjerë të cilët në mënyra të ndryshme ndikojnë në gjendjen aktuale të arsimit të komuniteteve rom dhe ashkali në Komunën e Shtimes.

**Tabela e Analizës SWOT në fushën e Arsimit**

| Sukseset – Përparësitë | Mundësitë |
| --- | --- |
| Ofrimi i bursave në nivel lokal për Studentët e komunitetit Ashkali dhe Rom.<br>• Ofrimi i mundësive të barabarta në nivel komunal për të gjithë (gjithpërfshirja)<br>• Funksionimi i Qendrave Mësimore në shkolla.<br>• Ngritja e vetëdijesimit të prindërve,<br>• Bashkëpunim i avancuar institucional, me OJQ-të dhe komunitetet<br>• Ofrimi i bursave për nxënësit e komuniteteve Ashkali dhe Rom në shkollimin e mesëm të lartë.<br>• Organizimi i fushatave për regjistrimin e fëmijëve në shkollë.<br>• Organizimi i transportit për nxënësit që udhëtojnë më shumë se 4 km<br>• Ulja e braktisjes së shkollimit të obliguar<br>• Përfshirja e fëmijëve te riatdhesuar në shkollë | • Zbatimi i projekteve të ndryshme nga donatorët dhe OJQ-të<br>• Funksionimi i Qendrave Mësimore në fshatin Gjurkoc dhe Vojnoc.<br>• Lirimi i nxënësve nga pagesa për edukimin jo-formal<br>• Mbështetje për studime jashtë vendit,<br>• Mbështetje për nxënës me mjete shkollore,<br>• Ndarja e bursave për studentë,<br>• Hapja e qendrave mësimore për komunitetet Ashkali dhe Rom me ndihmën e donatorëve.,<br>• Hapja e Qendrës për aftësim profesional në komunë,<br>• Organizimi i fushatave vetëdijësuese,<br>• Përfshirja e nënësve me aftësi të kufizuar në sistemin shkollorë,<br>• Rritje e përfshirjes të fëmijëve të komunitetit Ashkali dhe Rom, në kopshte përmes subvencionimit të pagesave të qerdhes.<br>• Përfshirja e nxënësve nga komuniteti Ashkali dhe Rom në edukimin e hershëm,<br>• Zhvillimi i vazhdueshem profesional për mësimdhënësit që punojnë me komunitete. |
| **Dobësitë** | **Rreziqet** |
| • Mos-vazhdimi i shkollimit të mesëm të lartë nga nxënësit e komuniteteve<br>• Suksesi i dobët i fëmijëve nga komunitetet<br>• Vetëdijësimi i ulët i prindërve të komuniteteve për rëndësinë e shkollimit<br>• Vështirësi për regjistrim në arsim e lartë të studentëve të komuniteteve<br>• Numri i vogël i mësimdhënësve nga komunitetet<br>• Mungesa e buxhetit për aktivitete kulturore<br>• Mungesa e kabineteve – infrastrukturës përcjellëse në shkolla<br>• Mungesa e mësimit shtesë në të gjitha shkollat<br>• Përfshirja e fëmijëve në edukimin parashkollor | • Mos-ndarja e buxhetit për mbështetjen e nxënësve të komuniteteve me mjete shkollore<br>• Martesat e hershme<br>• Ndërprerja e studimeve nga studentët për shkak të kushteve ekonomike<br>• Migrimi i të rinjve<br>• Thellimi i varfërisë<br>• Braktisja e shkollimit<br>• Largësia e shkollës – distanca shtëpi-shkolle<br>• Mungesa e dokumentacionit nga fëmijët e riatdhesuar |

## 2.2. Punësimi dhe mirëqenia sociale

**Te dhënat nga ASK për papunësim** - Papunësia në Kosovë sipas të dhënave të fundit nga Agjencia e Statistikave të Kosovës është **11.8%.** Raportet e fundit të publikuar nga ASK dhe nga hulumtime të ndryshme tregojnë që shkalla e papunësisë te komunitetet rom dhe ashkali është shumë më e madhe se sa vlerat në nivel vendi.

Statistikat nga ZKKK_tregojnë se gjatë vitit 2022, të punësuar në institucione publike në Komunën e Shtimes janë 13 ashkali, ndërsa në kompani private 22 të punësuar, prej tyre 2 rom dhe 20_ashkali. Megjithatë, ekziston një diferencë e lartë në mes të numrit të të punësuarve nga komunitetet dhe punëkërkuesve.

Përveç shkaktarëve të përgjithshëm që ndikojnë në nivelin e lartë të papunësisë, ka edhe shkaktarë të veçantë që i kontribuojnë papunësisë së madhe të komuniteteve rom dhe ashkali në Komunën e Shtimes. Njëri nga këta shkaktar është mungesa e kuadrove me kualifikime universitare nga radhët e këtyre komuniteteve, gjë që pamundëson ose vështirëson punësimin e tyre në mungesë të plotësimit të kritereve ligjore, posaçërisht në sektorin publik, sidomos deri në arritjen e plotësimit të kuotave për punësimin e komuniteteve që parashihen me ligj.

Komuna e Shtimes në bashkëpunim edhe me partnerë dhe donatorë të ndryshëm ka ofruar punë sezonale për punëkërkuesit nga komunitetet rom dhe ashkali.

Niveli i lartë i papunësisë së pjesëtarëve të komuniteteve rom dhe ashkali në Komunën e Shtimes ka ndikuar drejtpërdrejt edhe në mirëqenien sociale të tyre. Numri i familjeve të komuniteteve rom dhe ashkali që janë përfitues të skemave sociale është 43.

Nga numri i përgjithshëm i familjeve të komuniteteve rom dhe ashkali, asistencë sociale pranojnë 43 familje apo 0.43% e tyre. Numri i madh i familjeve që janë në asistencë sociale arsyeton edhe mosgatishmërinë e punëkërkuesve që të angazhohen në punë sezonale. Kjo ndodhë sepse gjatë punësimit sezonal këtyre familjeve u ndërpritet skema sociale, prandaj, meqë punësimi sezonal është i përkohshëm, shumë nga tu hezitojnë për të pranuar një punë të tillë, sepse pas përfundimit të kontratës së fituar gjatë punës sezonale, ballafaqohen me mjaft probleme për t'u rikthyer në skemë sociale përsëri.

Analiza SWOT nxjerr në pah edhe shumë faktorë të tjerë të cilët në mënyra të ndryshme ndikojnë në gjendjen e rëndë ekonomike dhe sociale të komuniteteve ashkali dhe rom në Komunën e Shtimes.

**Tabela e Analizës SWOT në fushën e Punësimit dhe Mirëqenies Sociale**

| Sukseset – përparësitë | Mundësitë |
|---|---|
| • Rritja e numri të të punësuarve në biznese private<br>• Përmirësimi i gjendjes ekonomiko-sociale përmes vetëpunësimit<br>• Subvencionimi dhe përkrahje nga donatorët për vetëpunësim<br>• Vetëdijësim i shtuar i komunitetit për kërkim të vendeve të punës | • Plotësim / Ndryshimi i Ligjit mbi skemën sociale.<br>• Punësimi i tre zyrtarëve nga komunitetet ashkali dhe rom në Administratën e Komunës ( ZKKK ) dhe rritja e të punësuarëve në ndërmarrjet publike.<br>• Punsim per shef të zyres (ZKKK).<br>• Respektimi në tërësi i dispozitave ligjore |

| | |
|---|---|
| • Ofrimi i pakove ushqimore nga Komuna për familjet në nevojë<br>• Ofrimi i punës praktike në institucionet publike në bashkëpunim me organizatat joqeveritare | të Ligjit të punës (10%).<br>• Përkrahja e bizneseve për punësimin e pjesëtarëve të komuniteteve me kontrata afatgjate.<br>• Përgatitja e kuadrove për punësim<br>• Ndjekja e kurseve-aftësimeve në QAP<br>• Përfshirja në punë praktike në institucione publike.<br>• Punësimi sezonal.<br>• Organizimi i kurseve për aftësim profesional për hapjen e bizneseve.<br>• Organizimi i fushatave vetëdijësuese dhe informuese.<br>• Organizimi i konferencës së donatorëve<br>• Ofrimi i subvencioneve për projekte biznesore familjare. |
| **Dobësitë** | **Rreziqet** |
| • Afati i shkurtër i Punësimit sezonal<br>• Mos zbatimi i kuotave të punësimit të komuniteteve në bazë të ligjit<br>• Mungesa e kuadrove profesionale<br>• Kufizimet nga Ligji mbi skemën sociale<br>• | • Ndikimi i politikës / politizimi.<br>• Mos zbatimi i Ligjit të punës.<br>• Mungesa e fondeve për ofrimin e trajnimeve të vazhdueshme në QAP.<br>• Mungesë e buxhetit për raste emergjente ekonomike / sociale (familjet e kthyera).<br>• Varësia e madhe e komunitetit nga institucionet publike.<br>• Mosplanifikimi familjar.<br>• Shtimi i numrit të rasteve sociale .<br>• Varësia nga ndihmat. |

### 2.3. Shëndetësia

Shërbimet shëndetësore në Komunën e Shtimes kanë një shtrirje të gjerë dhe mbulojnë mjaft mirë të gjithë territorin e komunës. Kjo komunë përveç Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF) disponon edhe me 3 Qendra të Mjekësisë Familjare (QMF).

Mbetet shqetësuese vetëdija e përgjithshme e popullatës nga komunitetet rom dhe ashkali për sa i përket sëmundjeve të ndryshme ngjitëse, dhe vaksinimit të fëmijëve. Në Komunën e Shtimes, përmes projekteve të ndryshme nga OSHC-të dhe donatorët, janë zhvilluar një varg i aktiviteteve të cilat kanë pasur një rol të rëndësishëm në mobilizimin e popullatës për të shfrytëzuar shërbimet shëndetësore, me theks të veçantë në aspektin parandalues të sëmundjeve të ndryshme, si dhe vaksinimit të fëmijëve.

Analiza SWOT e zhvilluar gjatë punëtorisë nxjerr në pah edhe shumë faktorë të tjerë të cilët në mënyra të ndryshme ndikojnë në shëndetin e komuniteteve ashkali dhe rom në Komunën e Shtimes.

**Tabela e Analizës SWOT në fushën e Shëndetësisë**

| Sukseset – përparësitë | Mundësitë |
|---|---|
| • Vaksinimi dhe rivaksinimi i fëmijëve<br>• Subvencionimi i rasteve me sëmundjeve të rënda nga komunitetet<br>• Organizimi i vizitave shtëpiake shëndetësore për pacientët<br>• Organizimi i fushatave vetëdijësuese për shëndetin<br>• Trajtim i barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë njerëzit në nevojë<br>• Organizimi i fushatave për ruajtjen nga sëmundjet ngjitëse | • Krijimi i databazës për sëmundjet kronike<br>• Ofrimi i ndihmave emergjente për pjesëtarët e komuniteteve rom dhe ashkali<br>• Nxitja e familjeve Rom dhe Ashkali për të ndjekur rregullisht-oraret e vaksinimit<br>• Përfshirja e një përfaqësuesi të komuniteteve ashkali ose rom në Këshillin e Pacientëve<br>• Krijimi i njësisë mobile për vizita në familjet e komuniteteve (avancimi)<br>• Rritja e numrit të studentëve në lëmin e shëndetësisë ( shkolla e mesme e lartë)<br>• Ofrimi trajnimeve këshilluese për shëndetin<br>• Shpërndarja e materialit informues për planifikim familjar dhe shëndet riprodhues<br>• Lirimi nga pagesa për familjet në nevojë<br>• Organizimi i kontrolleve sistematike për familjet në nevojë<br>• Ofrimi i trajnimit për stafin profesionist shëndetësor për mosdiskriminim në ofrimin e shërbimeve mjekësore |
| **Dobësitë** | **Rreziqet** |
| • Mundësitë e kufizuara për trajtim të rasteve te sëmundjeve kronike<br>• Mungesë e vetëdijes së komuniteteve për të drejtat e tyre në QKMF dhe QMF<br>• Edukimi i pamjaftueshëm shëndetësor<br>• Kushtet e rënda ekonomike ndikojnë në shëndetin e popullatës<br>• Mundësitë e vogla për punësimin e personelit mjekësor nga ana e komuniteteve<br>• Funksionalizim i pjesshëm i QMF-ve | • Buxheti i limituar<br>• Përhapja e sëmundjeve ngjitëse dhe epidemive<br>• Vdekjet e hershme<br>• Kufizimet ligjore për lirim nga pagesa për rastet e sëmundjeve |

### 2.4. Banimi

Gjendja në Komunën e Shtimes për sa i përket çështjes së banimit për komunitetet rom dhe ashkali në mënyrë të vazhdueshme është përmirësuar. Megjithatë, një numër i familjeve kanë probleme me kushte të vështira të banimit, kanë mungesë të pronave për ndërtim të shtëpive, kanë probleme me dokumentacion të pronës. Madje, edhe ato shtëpi që janë ndërtuar me

ndihmën e donatorëve dhe institucioneve nuk kanë mirëmbajtjen e duhur dhe janë shkatërruar shumë shpejt.

Vlerësohet se në Komunën e Shtimes ekzistojnë rreth 160 shtëpi ku jetojnë komunitetet ashkali dhe rom, përderisa 10 familje kanë paraqitur kërkesën për ndërtimin e shtëpive si dhe 16 familje nga komunitetet ashkali dhe rom kanë paraqitur kërkesën për renovimin e shtëpive.

Është me rëndësi të përmendet se përkeqësimit të situatës jo të mirë sa i përket banimit të komuniteteve rom dhe ashkali në Komunën e Shtimes i ka kontribuar edhe migrimi i disa familjeve në vendet e tjera, të cilat i kanë shitur apo i kanë lëshuar pronat ku kanë banuar dhe tani që rikthehen apo riatdhesohen nuk kanë më prona apo hapësira për banim. Po ashtu, gjatë vitit 2023, komuna në bashkëpunim me donatorët ka bërë edhe ndërtimin e 2 shtëpive për komunitetet ashkali. Vlen të përmendet, që për disa familje të cilat nuk posedojnë as pronë as shtëpi është bërë një zgjidhje e përkohshme, duke i sistemuar në objekte banimi me qera.

Analiza SWWOT ka nxjerr edhe disa të dhëna të tjera që janë të pasqyruara në tabelën e mëposhtme

**Tabela e Analizës SWWOT në fushën e Banimit**

| **Sukseset** | **Mundësitë** |
|---|---|
| • Ndihma emergjente e disa familjarëve për banim<br>• Ndërtimi i shtëpive (10 shtëpi)<br>• Pagesa e qirasë për familjet e komuniteteve<br>• Janë përgatitur dhe dërguar kërkesat për ndërtimin e shtëpive për rastet sociale, në Ministritë e caktuara<br>• Përmirësimi i kushteve për banim | • Krijimi i listës së nevojave me prioritet për banim social në nivelin komunal<br>• Krijimi i sektorit për banim në komunë<br>• Ndarja e buxhetit për zgjidhjen e problemit të banimit.<br>• Ndërtimi i shtëpive të reja në bashkëpunim me donatorë<br>• Përfshirja në mënyre specifike e komuniteteve rom dhe ashkali në plane trevjeçare të banimit social<br>• Renovimi i shtëpive ekzistuese<br>• Kregullimi i dokumenteve të pronës<br>• Ndarja e tokave për ndërtim<br>• Regjistrimi i pronave dhe legalizimi i tyre<br>• Ofrimi i ndihmës juridike falas për komunitetet rom dhe ashkali gjatë procesit të legalizimit në bashkëpunim me OSHC-të<br>• Lehtësimi i procedurave të legalizimit të pronave<br>• Krijimi i 5 grupeve mobile për asistimin e kompletimit të dokumentacionit përkatës pronësor<br>• Përmirësimi i infrastrukturës ekzistuese ne vendbanimet e komuniteteve rom dhe ashkali ku përcaktohen nevojat e tilla |

| | |
|---|---|
| | • Banesa kolektive për komunitete |
| **Dobësitë** | **Rreziqet** |
| • Mospërmbushja e nevojave për banim për të gjitha familjet në nevojë<br>• Buxheti i pamjaftueshëm<br>• Mungesa e dokumenteve të pronës<br>• Mos legalizimi i pronave<br>• Mos ndarja (dhënia) e banesave kolektive për komunitete | • Neglizhenca e institucioneve<br>• Migrimi për shkak të mungesë së banimit<br>• Mosrenovimi i shtëpive të vjetra<br>• Ndërtimi i shtëpive në ambiente jo të banueshme |

## 2.5. Diskriminimi

Diskriminimi, racizmi, stigmatizimi, gjuha e urrejtjes, dhuna e urrejtes, bullizmi, paragjykimi dhe perceptimet e gabuara për romët dhe ashkalinjtë ende mbizotërojnë në Kosovë si në vendet e tjera të Evropës. Diskriminimi në bazë të etnisë për komunitetet rom dhe ashkali është shkaktar i shumëfishtë i problemeve të këtyre komuniteteve dhe konsiderohet hendek kryesor i integrimit të këtyre komuniteteve në shoqëri dhe ekonomi. Diskriminimi përbën shkaqet kryesore për përjashtimin social të këtyre komuniteteve, ndërsa efektektet e situatës së tyre janë të dukshme në papunësinë e lartë, përqindjen e ulët të regjistrimit dhe arritjeve në arsim dhe kushtet e mjerueshme të jetesës së shumicës së këtyre komuniteteve.

Në komunën e Shtimes paraqitet një gjendje e kënaqëshme dhe relativisht e mirë sa i përket gjithëpërfshirjes në të gjitha sferat dhe objektivat që i paraqet ky plan i veprimit. Komuna e Shtimes angazhohet në ofrimin e mundësive, qasjes dhe trajtimit të barabartë për të gjithë qytetarët e komunës së Shtimes pa dallim etnie, religjioni, gjinie apo aftësie.

Familjet e komuniteteve ashkali dhe rom jetojnë në vendbanime të përziera me pjesën tjetër të popullatës shumicë, përderisa qasja, përfshirja, trajtimi në arsim, shëndetësi dhe jetën publike të këtyre komuniteteve janë në nivel të kënaqëshëm dhe në parim të barazisë dhe trajtimit të njejtë dhe të gjithëpërfshirjes.

Deri më tani në komunën e Shtimes nuk është paraqitur ndonjë rast i diskriminimit, bullizmit, segregimit, gjuhës së urrejtjes ose paragjykimit për komunitetin ashkali dhe komunitetin rom.

Tabela e Analizës SWOT në fushën e Diskriminimit

| Sukseset | Mundësitë |
|---|---|
| • Përfshirje dhe trajtim i barabartë i komuniteteve ashkali dhe rom në arsim, shëndetësi, punësim, shëndetësi dhe jetë sociale.<br>• Kritja e llogaridhënies dhe ndëshkimit ndaj ushtruesve të diskriminimit.<br>• Zyrtari përgjegjës për luftimin e diskriminimit, bullizmit, segregimit etj.<br>• | • Trajnime të vazhdueshme profesionale për zyrtarë publikë kundër antidiskriminimit<br>• Organizimi i fushatave ndërgjegjësuese për vetëdijesimin dhe ndërgjegjësimin e publikut dhe zyrtarëve publikë për racizëm dhe antidiskriminim ndaj komuniteteve Rom dhe Ashkali<br>• Ngritja e kapaciteteve profesionale në luftimin dhe parandalimin e diskriminimit.<br>• Mbështetja e OSHC-ve lokale për organizimin e aktiviteteve për luftimin e diskriminimit, paqen, të drejtat e njeriut etj dhe informimin e platformës kundër diskriminimit.<br>• Përfshirja e përfaqësuesve të komuniteteve rom dhe ashkali në hartimin e politikave lokale.<br>• Fushata ndërgjegjësuese për dhunën në familje dhe në baza gjinore<br>• Parandalimi dhe zvogëlimi i mbrojtjes së personave, lindja e të cilëve nuk është regjistruar. |
| **Dobësitë** | **Rreziqet** |
| • Buxheti i pamjaftueshëm | • Migrimi për shkak të kushteve ekonomike. |

## 3. OBJEKTIVAT DHE AKTIVITETET

Siç është paraqitur në analizën e gjendjes, ky plan i veprimit do t'i ketë 54 fusha kryesore të bazuara edhe në Strategjinë për Avancimin e të Drejtave të Komuniteteve Rom dhe Ashkali në Kosovë 2024-2026.

Për secilën nga këto fusha është përcaktuar një objektivë strategjike, ndërsa për çdo objektivë janë përcaktuar rezultatet të cilat do të arrihen duke i zbatuar aktivitetet specifike.

Më poshtë do të paraqiten objektivat strategjike, rezultatet dhe aktivitetet për secilën fushëveprim të Planit të Veprimit.

### 3.1. Arsimi

Është vërtetuar botërisht që ndryshimet në arsim i paraprijnë edhe ndryshimeve shoqërore. Duke u nisur nga kjo paradigmë, fusha e arsimit ka zënë një vend shumë të rëndësishëm në këtë Plan të veprimit.

Marrë për bazë situatën aktuale në fushën e arsimit për komunitetet rom dhe ashkali në Komunën e Shtimes, ky Plan i Veprimit parasheh një varg të aktiviteteve që duhet të ndërmerren për të avancuar pozitën e komuniteteve rom dhe ashkali në fushën e arsimit.

#### 3.1.1. Sfidat kryesore

Nga analiza e gjendjes që është bërë në kuadër të fushës së arsimit kanë dalë këto sfida kryesore:

- Përkrahja e pamjaftueshme për zbatimin e metodave të reja në klasë që do të ndihmonte në përfshirjen sa më të madhe të fëmijëve të komuniteteve rom dhe ashkali
- Bursat e pamjaftueshme për nxënës dhe studentë, për të përmirësuar përfshirjen e tyre në arsimin e mesëm të lartë dhe arsimin e lartë
- Vetëdijesimi i pamjaftueshëm i komunitetit për rëndësinë e shkollimit dhe bashkëpunimit me institucionet arsimore
- Braktisja / mos-regjistrimi nga ana e fëmijëve të komuniteteve rom dhe ashkali, në mënyrë të veçantë mosregjistrimi i shkollimit të mesëm të lartë nga vajzat.
- Mospërfshirja e fëmijëve në edukimin parashkollor dhe parafillor

**Objektiva strategjike 1**

Për të siguruar adresim të mirëfilltë të sfidave të renditura më lartë në fushën e arsimit është përcaktuar ky objektiv strategjik:

**Objektivi 1: Rritja e bashkëpunimit ndërsektorial në funksion të përfshirjes dhe ofrimit të mundësive për zhvillim, aftësim dhe arsimim cilësor për pjesëtarët e komuniteteve rom dhe ashkali**

#### 3.1.2. Rezultatet e pritshme

Për përmbushjen e objektivit strategjik të përcaktuar në këtë Plan Veprimi për fushën e arsimit parashihet arritja e rezultateve të pritshme në vijim:

- **Rezultati 1.1.** Përmirësohet qasja e fëmijëve të komuniteteve rom dhe ashkali në arsim
- **Rezultati 1.2.** Ndërgjegjësohen palët e interesit për të ndihmuar arsimimin e pjesëtarëve të komuniteteve rom dhe ashkali
- **Rezultati 1.3.** Sigurohet qasje në arsim për të gjithë fëmijët e komuniteteve rom dhe ashkali të riatdhesuar

### 3.1.3. Përshkrimi i aktiviteteve

| AKTIVITETI | PËRSHKRIMI I AKTIVITETIT |
|---|---|
| **Aktiviteti 1.1.1**<br>Identifikimi i fëmijëve në nevojë dhe sigurimi i mjeteve arsimore | ZKKK në bashkëpunim me DKA dhe QPS, bëjnë identifikimin e familjeve që kanë gjendje të rëndë ekonomike dhe që kanë fëmijë të moshës së arsimit të detyruar. Fëmijët e identifikuar duhet të pajisen me pako shkollore së paku një herë në vit.<br>Përveç përkrahjes me pako shkollore nga vet komuna, institucionet përgjegjëse mund të kërkojë edhe ndihmën e donatorëve dhe të bizneseve private për t'i përkrahur këta nxënës me pako shkollore apo edhe me veshmbathje. |
| **Aktiviteti 1.1.2**<br>Krijimi i sistemit të mbikëqyrjes për përfituesit e bursave nga nxënësit e komuniteteve rom dhe ashkali për arsimin e mesëm të lartë dhe arsimin e lartë | DKA në bashkëpunim me ZKKK duhet të krijojnë një databazë të të gjithë nxënësve nga komunitetet rom dhe ashkali të nivelit të arsimit të mesëm të lartë dhe atij universitar që janë përfitues të bursave. Në këtë databazë përveç të dhënave personale do të futen edhe niveli i vijueshmërisë së shkollimit, suksesi i nxënësit/studentit. Përmes këtij mekanizmi Komuna obligon secilin përfitues të dorëzoj të gjitha të dhënat e sipërpërmendura në DKA çdo fund-gjysmëvjetor apo fund-semestër. Kjo databazë do t'i shërbejë DKA si një mekanizëm kontrolli për të matur vijueshmërinë dhe suksesin e nxënësve dhe studentëve që janë përfitues të bursave.<br>Po ashtu, krijimi i një databaze të tillë do të ndihmonte DKA-në dhe Komunën në përgjithësi për të parandaluar keqpërdorimet e mundshme (p.sh. përfitimi i bursës nga i njëjti nxënës/student tek dy apo më shumë burime). |
| **Aktiviteti 1.1.3**<br>Organizohet mësimi intensiv për fëmijët që kanë vonesa në shkollimin e obliguar | DKA, ZKKK-në dhe shkollat në bashkëpunim MASHT-in dhe OJQ-të do të bëjnë identifikimin e të gjithë fëmijëve që kanë vonesa në shkollimin e obliguar. Duke u bazuar në gjendjen ekzistuese dhe në trendin e kthimit / ri-atdhesimit të familjeve nga vendet e ndryshme, supozohet që brenda 1 viti shkollor rreth 30 fëmijë të komuniteteve rom dhe ashkali do të përfitojnë mësimi intensiv. Mësimi intensiv do të aplikohet gjatë viteve të zbatimit të këtij Plani të Veprimit me qëllim të përfshirjes së të gjithë fëmijëve. Megjithatë, do të maksimizohen mundësitë që rastet që kanë mundësi, të përfshihen në sistemin e rregullt shkollor. |
| **Aktiviteti 1.1.4**<br>Krijimi i ambienteve të sigurta dhe atraktive në shkolla | DKA dhe shkollat në bashkëpunim edhe me OJQ-të dhe donatorët ndërmarrin aktivitete për të përmirësuar sigurinë e fëmijëve në shkolla. Me theks të veçantë shkollat me përkrahjen e DKA-së zbatojnë politika dhe aktivitete për parandalimin e dhunës në shkolla ku mund të përfshihen fëmijët nga grupet e cenueshme. |
| **Aktiviteti 1.1.5**<br>Organizimi i | DKA në bashkëpunim me donatorët dhe me OSHC-të që ofrojnë trajnime të kësaj natyre, organizojnë trajnime periodike kundër |

| | |
|---|---|
| trajnimeve kundër diskriminimit dhe paragjykimeve për mësimdhënës | diskriminimit dhe paragjykimeve për mësimdhënësit që punojnë me fëmijë të komuniteteve rom dhe ashkali.<br>Trajnimet e tilla do ti përgatisin mësimdhënësit që të krijojnë një ambient miqësor dhe përkrahës për të gjithë fëmijët në klasë, pa kurrfarë dallime. Po ashtu, këto trajnime do të ndihmojnë mësimdhënësit që të krijojnë klasa gjithëpërfshirëse, duke përmbushur nevojat e të gjithë nxënësve në klasë. |
| **Aktiviteti 1.1.6**<br>Monitorimi i suksesit dhe qëndrueshmëria e intervenimit | ZKKK në bashkëpunim me DKA dhe me shkollat monitorojnë suksesin e fëmijëve të komuniteteve rom dhe ashkali të cilët janë përfitues të skemave të ndryshme përkrahëse (përfituesit e bursave, përfituesit e pakove shkollore, përfituesit e mësimit intensiv). Në baza vjetore hartohet një raport i cili shpërndahen tek sektorët përgjegjës |
| [illegible] | [illegible] |
| **AKTIVITETI** | **PËRSHKRIMI I AKTIVITETIT** |
| **Aktiviteti 1.2.1**<br>Organizimi i fushatave vetëdijësuese për komunitetet rom dhe ashkali për rëndësinë e shkollimit | ZKKK dhe DKA, në bashkëpunim me shkollat, si dhe me përkrahjen e OSHC-ve dhe donatorëve të ndryshëm organizojnë fushata vetëdijësuese për familjet e komuniteteve rom dhe ashkali. Fushatat mund të bëhen në formë të kampanjave të ndryshme mediale, takime formale dhe jo-formale, organizimin e tryezave të diskutimit etj.<br>Përveç fushatave informuese, këtu mund të përfshihen edhe studentë nga komunitet rom dhe ashkali apo edhe personalitete të suksesshme të cilat do ti tregonin storiet e tyre të suksesit përmes vizitave nëpër familje, apo edhe përmes organizimit të sesioneve të ndryshime informative.<br>Fushatat dhe sesionet informuese organizohen në prag të konkurseve të shpallura nga shkollat dhe institucionet tjera arsimore. |
| **Aktiviteti 1.2.2**<br>Organizimi i aktiviteteve të përbashkëta prind-komunitet-shkollë | ZKKK, DKA, DKRS në bashkëpunim edhe me shkollat, si dhe me përkrahjen e OSHC-ve dhe donatorëve të ndryshëm organizojnë Aktivitete për fëmijët dhe prindërit e komuniteteve rom dhe ashkali, me qëllim të motivimit të nxënësve dhe prindërve për përfshirjen ne arsim.<br>Aktivitetet organizohen gjatë periudhës kur janë afatet për regjistrim në shkollë fillore dhe të mesme të lartë apo edhe duke shënuar Festat dhe Ditët e ndryshme Ndërmkombëtare (p.sh. 1 Qershori - Dita e Fëmijëve; Dita Ndërkombëtare e leximit - 8 shtator; Muajit të Rinisë etj.) |
| [illegible] | [illegible] |
| **AKTIVITETI** | **PËRSHKRIMI I AKTIVITETIT** |
| **Aktiviteti 1.3.1.**<br>Identifikohen dhe adresohen rastet e | ZKKK në bashkëpunim me sektorët tjerë në nivel komune, identifikon familjet e ri-atdhesuara të cilat kanë fëmijë të moshës shkollore. Pas identifikimit, ZKKK ndërmerr të gjithë hapat për të adresuar në |

| | |
|---|---|
| fëmijëve të ri-atdhesuar | mënyrën më të mirë nevojat e këtyre familjeve. ZKKK krahas përkrahjes që ofron në kuadër të politikave të ri-atdhesimit, do të ofrojë edhe përkrahje shtesë për fëmijët e moshës shkollore p.sh. përkrahje për t'u pajisur me dokumentacionin përkatës, përkrahje për të nostrifikuar dokumentet. Kjo përkrahje nënkupton mbulimin e shpenzimeve financiare për këto shërbime dhe për vajtje-ardhje në MASHT/Prishtinë. Supozohet që brenda një viti mund të ketë 10 raste të tilla. |

#### 3.1.4. Supozimet dhe rreziqet

Supozimet kryesore për të siguruar arritjen e Objektivit 1 të paraparë me këtë dokument janë:

- Të gjitha palët e përfshira kanë vullnet dhe angazhohen për rritjen e nivelit të përfshirjes, zvogëlimin e rasteve të braktisjeve të shkollimit dhe përmirësimin e suksesit të nxënësve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në arsimin parauniversitar, duke i realizuar aktivitetet e parapara me këtë dokument;
- MASHT tregon përkushtim për përfshirjen në mësim intensiv të fëmijëve nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian që kanë vonesa në shkollimin e obliguar
- Mësimdhënësit e trajnuar do të zbatojnë metoda dhe teknika në procesin mësimor për të siguruar një ambient mik për të gjithë fëmijët, pa dallime

Ndërkaq, faktorët që mund ta rrezikojnë arritjen e Objektivit 1 të paraparë me këtë dokument janë:

- Mosgatishmëria e shkollave për të zbatuar politikat antidiskriminuese
- Mungesa e buxhetit nga MASHT për përkrahje të mësimit intensiv
- Mosgatishmëria e komunitetit për të bashkëpunuar me institucionet për të adresuar problemet e përfshirjes në arsim

### 3.2. Punësimi dhe mirëqenia sociale

Gjatë punës për hartimin e këtij Plani të Veprimit është konstatuar se përmirësimet në këtë fushë do të kenë ndikim shumë të madh në përmirësimin e mirëqenies sociale, do të motivoj të rinjtë që t'i kushtojnë më shumë rëndësi shkollimit, rrjedhimisht, shumë probleme të identifikuara në kuadër të këtij Plani do të adresoheshin apo zgjidheshin.

Marrë parasysh rëndësinë që kanë intervenimet në këtë fushë, Punësimi dhe mirëqenia sociale është përmbledhur në një objektiv strategjik të Planit, që parasheh ndërmarrjen e disa veprimeve që do të ndikonin në përmirësimin e gjendjes ekonomike-sociale të komuniteteve rom dhe ashkali.

#### 3.2.1. Sfidat kryesore

Nga analiza e gjendjes që është bërë në kuadër të kësaj fushe, janë identifikuar një numër i madh i sfidave me të cilat ballafaqohet ky sektor. Më poshtë do të paraqesim disa prej sfidave që janë konsideruar si prioritare për t'u adresuar brenda periudhës zbatuese të Planit të Veprimit:

- Niveli i ulët i punësimit nga radhët e komuniteteve rom dhe ashkali
- Mungesa e shkollimit dhe kualifikimeve adekuate, iu vështirëson gjetjen e vendeve të punës

- Kufizimet buxhetore të Komunës, pamundësojnë ofrimin e shërbimeve sociale për të gjitha rastet në nevojë nga komunitetet.
- Kriteret për përfitim të asistencës sociale janë shumë të ashpra, dhe në shumë raste edhe joadekuate për nevojat e komuniteteve rom dhe ashkali

**Objektiva strategjike 2**

Për të siguruar adresim të mirëfilltë të sfidave të renditura më lartë në fushën e punësimit është përcaktuar ky objektiv strategjik:

**Objektivi 2: Përmirësimi i mirëqenies dhe standardit jetësor përmes sigurimit të punësimit të qëndrueshëm dhe shërbimeve sociale efikase**

### 3.2.2. Rezultatet e pritshme

Për përmbushjen e objektivit strategjik të përcaktuar në këtë Plan Veprimi për fushën e punësimit dhe mirëqenies sociale parashihet arritja e rezultateve të pritshme në vijim:

- **Rezultati** 2.1.Përmirësohet përfshirja e pjesëtareve të komuniteteve rom dhe ashkali në punësim
- **Rezultati** 2.2.Përmirësohet pjesëmarrja në skemat sociale e familjeve në nevojë nga komunitetet rom dhe ashkali

### 3.2.3. Përshkrimi i aktiviteteve

| [illegible] | [illegible] |
|---|---|
| **AKTIVITETI** | **PËRSHKRIMI I AKTIVITETIT** |
| **Aktiviteti 2.1.1** Fushatë informuese dhe avokuese për respektim të kuotës së punësimit për komunitetet | ZKKK në bashkëpunim me Zyrën e Punësimit si dhe me përkrahjen e OSHC-ve dhe donatorëve të ndryshëm organizojnë fushatë avokuese në nivel komunal për të avancuar zbatimin e kuotës së punësimit për komunitetet rom dhe ashkali. Kjo fushatë do të koordinohet nga ZKKK dhe ka për qëllim informimin e të gjitha institucioneve në nivel komune, bizneseve, punëdhënësve potencial, por edhe publikut në përgjithësi për kuotat e përcaktuara me ligj për punësimin e pjesëtarëve të komuniteteve. Pjesë integrale e kësaj fushate do të jetë edhe Inspektorati i Punës, të cilët do të informonin të punësuarit për dëmet dhe pasojat e ekonomisë informale. |
| **Aktiviteti 2.1.2** Identifikimi i fuqisë punëtore nga komunitetet rom dhe ashkali dhe ofrimi i këshillave për punësim | ZKKK në bashkëpunim me Zyrën e Punësimit bënë identifikimin e fuqisë punëtore nga komunitetet ashkali dhe rom (i të papunëve dhe punëkërkuesve) dhe harton një databazë. Në bazë të nevojës harton plane përkrahëse këshilluese. ZKKK ndërmjetëson në raste të ndryshme me qëllim të rritjes së punësimit të përfaqësuesve të komuniteteve. |
| **Aktiviteti 2.1.3** Ofrimi i kurseve shtesë për aftësim profesional dhe kurseve artizanale | ZKKK në bashkëpunim me Zyrën e Punësimit bënë identifikimin e të gjithë punëkërkuesve nga komunitetet rom dhe ashkali. Në koordinim të ngushtë me Qendrat për Aftësim Profesional, duke u bazuar në nevojat e punëkërkuesve nga komunitetet rom dhe ashkali, harton plane për përfshirjen në kurse për aftësim profesional. |

| | |
|---|---|
| për punëkërkuesit nga komunitetet rom dhe ashkali | Në rastet kur kurset që kërkohen (sidomos ato artizanale) ZKKK dhe Zyra e punësimit mund të gjejnë alternativë për organizimin e këtyre kurseve nga QAP-at e tjera. Kjo mund të bëhet duke organizuar transportin për të interesuarit, deri tek QAP-at nga qytetet tjera. |
| **Aktiviteti 2.1.4** Përkrahje për të rinjtë nga komunitetet për të hapur biznese të reja | Komuna e Shtimes në bashkëpunim me donatorët potencial ofrojnë mundësi aplikimi për të rinjtë nga komunitetet që kanë përfunduar shkollimin e lartë, me ide për start-up biznese.<br><br>Praktikat e deritanishme kanë treguar që komuniteti i donatorëve është i interesuar për të përkrahur krijimin e bizneseve të reja. Komuna do të shfrytëzoj këto mundësi duke participuar me mjete vetanake në nisma të tilla. |

[illegible]

| AKTIVITETI | PËRSHKRIMI I AKTIVITETIT |
|---|---|
| **Aktiviteti 2.2.1** Identifikimi dhe vlerësimi i nevojave të familjeve në nevojë për përfshirje në skemat sociale | Në Komunën e Shtimes ka pasur raste, kur familjet në nevojë për shkak të neglizhencës kanë humbur asistencën sociale, apo nuk janë fare përfitues të skemave sociale. Kjo ka ardhur si pasojë e mos-informimit të familjeve me kushtet, procedurat dhe kriteret për të qenë përfitues i skemave sociale. Për të shmangur situata të tilla, ZKKK, DSHMS dhe QPS në bashkëpunim me OSHC-të identifikojnë nevojat e të gjitha familjeve nga komunitetet ashkali dhe rom që kanë nevojë për tu përfshirë në skema sociale. Sipas nevojave të identifikuara, DSHMS dhe QPS do të ndërmarrë të gjithë hapat e nevojshëm për ti përfshirë në skemat sociale familjet në nevojë. Theks i veçantë do ti kushtohet familjeve që kanë fëmijë me aftësi të kufizuara. |
| **Aktiviteti 2.2.2** Parandalimi i punëve të rënda dhe mbrojtja e fëmijëve të komuniteteve rom dhe ashkali | Rastet e shumta të shfrytëzimit të fëmijëve qoftë për punë të rënda apo edhe shfrytëzimit të tyre për të kërkuar lëmoshë, obligojnë institucionet lokale që të zbatojnë masa për parandalimin e keqpërdorimit të fëmijëve. ZKKK do të ketë rol monitorues dhe mobilizues për të njoftuar institucionet dhe mekanizmat tjerë, në mënyrë që të parandalohet çdo keqpërdorim i fëmijëve të komuniteteve qoftë nga familja, apo grupet tjera të interesit. |
| **Aktiviteti 2.2.3** Koordinim i shtuar në mes sektorëve komunal për të avancuar qasjen e pjesëtarëve të komuniteteve rom dhe ashkali në punësim dhe shërbime sociale | ZKKK do të themelojë një mekanizëm komunal ndërsektoral që do të ketë për mandat koordinimin e të gjithë akterëve për të avancuar qasjen e pjesëtarëve të komuniteteve rom dhe ashkali në punësim dhe shërbime sociale.<br><br>Në këtë mekanizëm do të bëjnë pjesë: ZKKK (koordinator), DSHMS, QPS, Zyra e punësimit, DKA, OJQ-të, bizneset etj. Varësisht nga nevojat, ky mekanizëm mund të zgjerohet edhe me përfaqësues nga palët me interes. |

| | |
|---|---|
| **Aktiviteti 2.2.4** Organizim i takimeve periodike për koordinim në mes të sektorëve | ZKKK si koordinatore e Grupit koordinues do të organizojë takime periodike (2 herë në vit) për të siguruar që janë ndërmarrë të gjithë hapat e nevojshëm për të avancuar qasjen e pjesëtarëve të komuniteteve rom dhe ashkali në punësim dhe shërbime sociale.<br><br>Varësisht nga nevoja, ky Grup mund të takohet edhe më shpesh për të trajtuar çështjet dhe sfidat që paraqiten. |

### 3.2.4. Supozimet dhe rreziqet

Supozimet kryesore për të siguruar arritjen e Objektivit 2 të paraparë me këtë dokument janë:

- Të gjitha palët e përfshira kanë vullnet dhe angazhohen për realizimin e aktiviteteve të parapara me këtë dokument;
- Bizneset tregojnë gatishmëri për të punësuar pjesëtarë nga komunitetet rom dhe ashkali

Ndërkaq, faktorët që mund ta rrezikojnë arritjen e Objektivit 2 të paraparë me këtë dokument janë:

- Mungesa e angazhimit dhe përkushtimit të palëve të përfshira për të marrë përgjegjësitë që dalin nga ky Plan;
- Mungesa e bashkëpunimit nga bizneset përfituese të subvencioneve
- Mungesa e bashkëpunimit nga vetë pjesëtarët e komuniteteve

## 3.3. Shëndetësia

Edhe përkundër shumë intervenimeve që janë bërë në përmirësimin e shëndetit të komuniteteve rom dhe ashkali, në Komunën e Shtimes ka nevojë të intervenohet në disa aspekte.

Faktorët që ndikojnë në shëndetin e njeriut janë të ndryshëm e në shumë raste edhe të pa menaxhueshëm, megjithatë, aspekte si: Vaksinimi i fëmijëve dhe në përgjithësi niveli i ulët i vetëdijes për tu përkujdesur më shumë për shëndetin mund të përmirësohen.

Marrë parasysh rëndësinë që kanë intervenimet në këtë fushë, ky Plan parasheh ndërmarrjen e disa veprimeve që do të ndikonin në përmirësimin e gjendjes së shëndetit të komuniteteve rom dhe ashkali.

### 3.3.1. Sfidat kryesore

Nga analiza e gjendjes që është bërë në kuadër të kësaj fushe, janë identifikuar një numër i madh i sfidave me të cilat ballafaqohet ky sektor. Më poshtë do të paraqesim disa prej sfidave që janë konsideruar si prioritare për t'u adresuar brenda periudhës zbatuese të Planit:

- Niveli i ulët i vaksinimit të fëmijëve të komuniteteve rom dhe ashkali
- Mungesa e informimit dhe edukimit shëndetësor rreth çështjeve jetike shëndetësore për komunitetet rom dhe ashkali
- Mungesa e mjeteve financiare për të përmbushur nevojat për trajnim shëndetësor

**Objektiva strategjike 3**

Për të siguruar adresim të mirëfilltë të sfidave të renditura më lartë në fushën e shëndetësisë është përcaktuar ky objektiv strategjik:

**Objektivi 3: Përmirësimi i gjendjes shëndetësore dhe cilësisë së jetës te pjesëtarët e komuniteteve rom dhe ashkali**

**3.3.2. Rezultatet e pritshme**

Për përmbushjen e objektivit strategjik të përcaktuar në këtë Plan Veprimi për fushën e shëndetësisë parashihet arritja e rezultateve të pritshme në vijim:

- **Rezultati** 3.1.Përmirësohet qasja në shërbime shëndetësore për pjesëtarët e komuniteteve rom dhe ashkali
- **Rezultati** 3.2.Sigurohet një mjedis i shëndetshëm për popullsinë e komuniteteve rom dhe ashkali

**3.3.3. Përshkrimi i aktiviteteve**

| AKTIVITETI | PËRSHKRIMI I AKTIVITETIT |
|---|---|
| **Aktiviteti 3.1.1**<br>Organizimi i vizitave periodike shëndetësore ne familjet e komuniteteve nga QKMF | Rritja e besueshmërisë së familjeve të komuniteteve, veçmas fëmijëve, në raport me institucionet shëndetësore dhe familjarizimi me to, do të ndikonte në ngritjen e vetëdijes së pjesëtarëve të komuniteteve për të shfrytëzuar këto shërbime.<br>QKMF me përkrahjen e DSHMS dhe ZKKK, organizon vizita periodike në familjet e komuniteteve rom dhe ashkali. Qëllimi i vizitave do të jetë ofrimi i shërbimeve shëndetësore për të gjithë nevojtarët, dhe në të njëjtën kohë edhe informimi i familjeve për rëndësinë e përkujdesjes ndaj shëndetit. |
| **Aktiviteti 3.1.2**<br>Identifikimi i fëmijëve të pa imunizuar dhe imunizimi i tyre | ZKKK në bashkëpunim me DSHMS bëjnë identifikimin e të gjithë fëmijëve që nuk iu kanë nënshtruar procesit të imunizimit.<br>Pas identifikimit të tyre, përmes vizitave familjare, apo edhe përmes organizimit të vizitave kolektive në lokacione të caktuara, bëhet imunizimi i tyre.<br>Ky aktivitet mund të organizohet në bashkëpunim me Qendrat e Komuniteteve (aty ku ekzistojnë), OJQ-të apo edhe me institucionet arsimore. |
| **Aktiviteti 3.1.3**<br>Ndarja e buxhetit për trajtimin e rasteve shëndetësore nga | Shërbimet që ofrohen nga QKMF dhe QMF shpeshherë nuk i përmbushin nevojat e pacienteve, veçmas kur paraqiten raste më të rënda të cilat kanë nevojë për një tretman më të veçantë. Praktikat e mëhershme nga Komuna e Shtimes, tregojnë se në disa raste Komuna |

| | |
|---|---|
| komunitetet | ka ndihmuar financiarisht trajtimin e këtyre rasteve. Duke u bazuar në supozimin që pjesëtarët e komuniteteve rom dhe ashkali janë më të predispozuar ndaj këtyre rasteve, nevojitet një fond i paracaktuar për të ndihmuar këto raste.<br><br>ZKKK do të ketë rol koordinues në identifikimin e këtyre rasteve, apo do të jetë adresë për të kërkuar ndihmën e tillë. Ndërsa, mjetet për trajtimin e këtyre rasteve do të ndahet direkt nga Komuna. |
| [illegible] | [illegible] |
| **AKTIVITETI** | **PËRSHKRIMI I AKTIVITETIT** |
| **Aktiviteti 3.2.1**<br>Organizimi i ligjëratave rreth edukimit shëndetësor dhe planifikimit familjar | DSHMS në bashkëpunim të ngushtë QKMF dhe QMF duhet të organizojnë ligjërata të strukturuara rreth edukimit shëndetësor për familjet e komuniteteve rom dhe ashkali.<br><br>Vend të rëndësishëm gjatë këtyre ligjëratave duhet të zë edhe çështja e planifikimit familjar. Për të realizuar këto ligjërata, DSHMS do të bashkëpunoj edhe me OJQ lokale që punojnë në këtë fushë, por edhe me udhëheqësit e lagjeve, përkatësisht përfaqësuesit e komunitetit. |
| **Aktiviteti 3.2.2**<br>Organizimi i fushatave vetëdijësuese për shërbimet që ofrojnë QMF | QKMF dhe QMF në bashkëpunim edhe me OSSC-të, duhet të organizojnë fushata vetëdijësuese, ku target do të jenë familjet nga komunitetet rom dhe ashkali, me qëllim të informimit të tyre për shërbimet që ofrohen në QMF. |
| **Aktiviteti 2.2.3**<br>Organizimi i vizitave periodike për mamografi – ne koordinim me ZKKK | DSHMS në bashkëpunim me ZKKK dhe MSH/QKUK organizojnë vizita periodike për mamografi. Kjo mund të realizohet duke i organizuar këto vizita në QKMF apo edhe duke i organizuar vizitat në komunitet përmes Mamografit Mobil që menaxhohet nga MSh. |

### 3.3.4. Supozimet dhe rreziqet

Supozimet kryesore për të siguruar arritjen e Objektivit 3 të paraparë me këtë dokument janë:

- Të gjitha palët e përfshira kanë vullnet dhe angazhohen për realizimin e aktiviteteve të parapara me këtë plan;
- Gatishmëria e familjeve për të vazhduar ciklin e imunizimit të fëmijëve;

Ndërkaq, faktorët që mund ta rrezikojnë arritjen e Objektivit 3 të paraparë me këtë dokument tjanë:

- Mungesa e angazhimit dhe përkushtimit të palëve të përfshira për të marrë përgjegjësitë që dalin nga ky plan;
- Mosgatishmëria e stafit të QKMF/QMF për të zhvilluar vizitat në terren

### 3.4. Banimi

Çështja e banimit për familjet e komuniteteve rom dhe ashkali vazhdon të jetë fokus i intervenimeve nga Komuna e Shtimes.

Kthimi dhe ri-atdhesimi i familjeve nga komunitet rom dhe ashkali mund ta vështirësoj dhe thelloj problematikën e vendbanimeve. Migrimi i shumë familjeve në fillimin e vitit 2014, ku shumë familje kanë shitur shtëpitë e tyre për të kërkuar jetë më të mirë në vendet e perëndimit, e ka thelluar dukshëm mungesën e vendbanimeve, sidomos, pas kthimit të tyre.

Për të adresuar sa më mirë këtë çështje, komuna e Shtimes duhet të ndërmarrë masa dhe veprime konkrete. Të gjitha këto masa dhe veprime janë përmbledhur në objektiven e katërt të këtij Plani.

#### 3.4.1. Sfidat kryesore

Nga analiza e gjendjes që është bërë në kuadër të kësaj fushe, janë identifikuar një numër i madh i sfidave me të cilat ballafaqohet ky sektor. Më poshtë do të paraqesim disa prej sfidave që janë konsideruar si prioritare për tu adresuar brenda periudhës zbatuese të Planit:

- Mos përmbushja e nevojave për banim për të gjitha familjet në nevojë
- Mungesa e mjeteve financiare për ndërtimin / renovimin e shtëpive për familjet në nevojë
- Mungesa e dokumentacionit nga pronarët

**Objektiva strategjike 4**

Për të siguruar adresim të mirëfilltë të sfidave të renditura më lartë në fushën e shëndetësisë është përcaktuar ky objektiv strategjik:

**Objektivi 4: Sigurimi i strehimit dhe banimit formal për familjet e komuniteteve rom dhe ashkali**

#### 3.4.2. Rezultatet e pritshme

Për përmbushjen e objektivit strategjik të përcaktuar në këtë Plan Veprimi për fushën e banimit parashihet arritja e rezultateve të pritshme në vijim:

- **Rezultati 4.1.**Avancim i ndjeshëm drejt zgjidhjes së problemit të banimit për pjesëtarët e komuniteteve rom dhe ashkali
- **Rezultati 4.2.**Ekziston Fondi Emergjent Komunal për nevojat e zgjidhjes së rasteve të banimit / bashkëfinancim të projekteve nga donatorët

#### 3.4.3. Përshkrimi i aktiviteteve

| | |
|---|---|
| [illegible] | [illegible] |
| AKTIVITETI | PËRSHKRIMI I AKTIVITETIT |

| | |
|---|---|
| **Aktiviteti 4.1.1**<br>Hartimi i databazës së familjeve të pastrehë / familjeve në nevojë për banim | ZKKK në bashkëpunim me Komitetin për Komunitete dhe në koordinim me përfaqësuesit e komuniteteve rom dhe ashkali bënë identifikimin e të gjitha familjeve të pastrehë apo që kanë nevojë për banim..<br><br>Të dhënat e detajuara për secilën familje do të futen në një databazë e cila do të shfrytëzohet edhe nga institucione tjera komunale. Hartimi i kësaj databaze duhet të jetë një proces i vazhdueshëm për shkak të lëvizjeve të mëdha që ndodhin, më konkretisht, për shkak të ndërrimit të vendbanimeve nga familjet, ri-atdhesimin e familjeve, apo për shkak të paraqitjes së rasteve të reja për banim. |
| **Aktiviteti 4.1.2**<br>Zbatimi i kritereve për përfituesit e mundshëm / për ndërtim apo renovim të shtëpisë sipas Programit trevjeçar të banimit | ZKKK në koordinim me donatorët dhe me përgjegjësit do të përkujdeset që Programi trevjeçar i banimit të zbatohet dhe të shfrytëzohen kriteret që burojnë nga ky program për përzgjedhjen e përfituesve të ndërtimit/renovimit të shtëpive për nevojtarët. |
| **Aktiviteti 4.1.3**<br>Monitorim i vazhdueshëm i procesit të shpalljes së përfituesve të objekteve të banimit apo renovimit të shtëpive ekzistuese | Komuna në bashkëpunim me ZKKK do të përkujdesen që procesi i ndarjes së banesave / përcaktimit të përfituesve potencial do të jetë proces transparent.<br><br>OSHC-të do të kenë rol monitorues gjatë gjithë procesit, ndërsa dokumentet e prodhuara nga ky proces duhet të jenë të qasshme për të gjithë të interesuarit.<br><br>Pas procesit të ndarjes së banesave / përcaktimit të përfituesve potencial për renovim, Komuna duhet të hartoj një raport përmbledhës i cili do të jetë në dispozicion për publikun. |
| [redacted] | [redacted] |
| **AKTIVITETI** | **PËRSHKRIMI I AKTIVITETIT** |
| **Aktiviteti 4.2.1**<br>Organizimi i takimeve avokuese për të adresuar problemin e banimit për komunitetet në veçanti të rikthyerit – Rëndësia e themelimit të Fondit Emergjent | Përfaqësuesit e ZKKK zhvillojnë një plan të takimeve me Kabinetin e Kryetarit dhe me asamblistë për të adresuar problemin e banimit për komunitetet e në veçanti për rastet e rikthyera apo rastet që nuk e kanë të zgjidhur këtë problem. Takimet do të kenë karakter avokues, në mënyrë që të shtyhet përpara Themelimi i Fondit Emergjent për rastet e banimit |

| | |
|---|---|
| **Aktiviteti 4.2.2** Hartimi i dokumentacionit përcjellës për themelimin e Fondit | ZKKK merr rol kryesor në hartimin e dokumentacionit për themelimin e Fondit Emergjent për rastet e banimit. ZKKK me përkrahjen e kabinetit të kryetarit caktojnë grupin punues për të hartuar dokumentacionin përcjellës për themelimin e këtij Fondi. Dokumenti kryesor që duhet të hartohet është: Akti i Themelimit - Statuti; ku do të përfshihen këto informata:<br>o Mënyra e shfrytëzimit të Fondit<br>o Rastet kur mund të shfrytëzohet Fondi<br>o Kriteret për përfituesit nga ky Fond<br>o Caktimi i mekanizmit në nivel komunal për menaxhimin e Fondit<br>o Shfrytëzimi i Fondit për bashkëfinancimi i projekteve te donatorëve etj." |
| **Aktiviteti 4.2.3** Takime periodike me donatorët potencial që do të kontribuonin në Fondin Emergjent për Banim | ZKKK në koordinim me Kryetarin e Komunës organizon konferencë të donatorëve një herë në vit me qëllim të informimit për ekzistimin e një Fondi të tillë dhe mundësisë së gjetjes së mënyrave të bashkëpunimit / bashkëfinancimit të projekteve të ndryshme që kanë për qëllim zgjidhjen e problemit të banimit për rastet në nevojë. |

### 3.4.4. Supozimet dhe rreziqet

Supozimet kryesore për të siguruar arritjen e Objektivit 4 të paraparë me këtë dokument janë:

Institucionet qendrore të Kosovës dhe donatorët ndërkombëtarë përkrahin Komunën e Shtimes për ndërtimin / renovimin e shtëpive për familjet e pastreha të komuniteteve rom dhe ashkali, në përputhje me masat dhe aktivitetet e parapara në Strategjinë për Avancimin e të Drejtave të Komuniteteve Rom dhe Ashkali në Kosovë 2022-2026.

Ndërkaq, faktorët që mund ta rrezikojnë arritjen e Objektivit 4 të paraparë me këtë dokument janë:

Mos ndarja e buxhetit nga institucionet qendrore të Kosovës dhe nga donatorët, siç parashihet në Strategjinë për Avancimin e të Drejtave të Komuniteteve Rom dhe Ashkali në Kosovë 2022-2026.

# PLANI LOKAL I VEPRIMIT PËR PËR AVANCIMIN E TË DREJTAVE TË KOMUNITETEVE ROM 2024-2026

**Fusha:** ARSIMI

**Objektivi 1:** Rritja e bashkëpunimit ndër-sektorial në funksion të përfshirjes dhe ofrimit të mundësive për zhvillim, aftësim dhe arsi

| Rezultati 1.1 | Përmirësohet qasja e fëmijëve të komuniteteve rom dhe ashkali në arsim | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **Kodi** | **Aktiviteti** | **Përshkrimi i Aktivitetit** | **Periudha e implementimit** | **Përgjegjësia** | **Institucioni/organizata mbështetëse** |
| 1.1.1 | **Identifikimi i fëmijëve në nevojë dhe sigurimi i mjeteve arsimore** | ZKKK në bashkëpunim me DKA dhe QPS, bëjnë identifikimin e familjeve që kanë gjendje të rëndë ekonomike dhe që kanë fëmijë të moshës së arsimit të detyruar. Fëmijët e identifikuar duhet të pajisen me pako shkollore së paku një herë në vit. Përveç përkrahjes me pako shkollore nga vet komuna, institucionet përgjegjëse mund të kërkojë edhe ndihmën e donatorëve dhe të bizneseve private për t'i përkrahur këta nxënës me pako shkollore apo edhe me veshmbathje. | 2024-2026 | DKA, ZKKK | DShMS, QPS, Donatorët |
| 1.1.2 | **Krijimi i sistemit të mbikëqyrjes për përfituesit e bursave nga nxënësit e komuniteteve rom dhe ashkali për arsimin e mesëm të lartë dhe arsimin e** | DKA në bashkëpunim me ZKKK duhet të krijojnë një databazë të të gjithë nxënësve nga komunitetet rom dhe ashkali të nivelit të arsimit të mesëm të lartë dhe atij universitar që janë përfitues të bursave. Në këtë databazë përveç të dhënave personale do të futen edhe niveli i vijueshmërisë së shkollimit, suksesi i nxënësit/studentit. Përmes këtij mekanizmi Komuna obligon secilin përfitues të dorëzoj të gjitha të dhënat e sipërpërmendura në DKA çdo fund-gjysmëvjetor apo fund-semestër. Kjo databazë do t'i shërbej DKA si një | 2024-2026 | DKA | ZKKK, Donatorët |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 1.1.3 | **Organizohet mësimi intensiv për fëmijët që kanë vonesa në shkollimin e obliguar** | DKA, ZKKK dhe shkollat në bashkëpunim MASHT dhe OJQ-të do të bëjnë identifikimin e të gjithë fëmijëve që kanë vonesa në shkollimin e obliguar. Duke u bazuar në gjendjen ekzistuese dhe në trendin e kthimit / ri-atdhesimit të familjeve nga vendet e ndryshme, supozohet që brenda 1 viti shkollor rreth 30 fëmijë të komuniteteve rom dhe ashkali do të përfitojnë mësimi intensiv. Mësimi intensiv do të aplikohet gjatë viteve të zbatimit të këtij Plani të Veprimit me qëllim të përfshirjes së të gjithë fëmijëve. Megjithatë, do të maksimizohen mundësitë që rastet që kanë mundësi, të përfshihen në sistemin e rregullt shkollor. | 2024-2026 | DKA, MASHT | OJQ-të, Donatorët |
| 1.1.4 | **Krijimi i ambienteve të sigurta dhe atraktive në shkolla** | DKA dhe shkollat në bashkëpunim edhe me OJQ-të dhe donatorët ndërmarrin aktivitete për të përmirësuar sigurinë e fëmijëve në shkolla. Me theks të veçantë shkollat me përkrahjen e DKA-së zbatojnë politika dhe aktivitete për parandalimin e dhunës në shkolla ku mund të përfshihen fëmijët nga grupet e cënueshme. | 2024-2026 | DKA, MASHT | OJQ-të, Donatorët |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1.1.5 | **Organizimi i trajnimeve kundër diskriminimit dhe paragjykimeve për mësimdhënës** | DKA në bashkëpunim me donatorët dhe me OSHC-të që ofrojnë trajnime të kësaj natyre, organizojnë trajnime periodike kundër diskriminimit dhe paragjykimeve për mësimdhënësit që punojnë me fëmijë të komuniteteve rom dhe ashkali.<br>Trajnimet e tilla do ti përgatisin mësimdhënësit që të krijojnë një ambient miqësor dhe përkrahës për të gjithë fëmijët në klasë, pa kurrfarë dallime. Po ashtu, këto trajnime do të ndihmojnë mësimdhënësit që të krijojnë klasa gjithëpërfshirëse, duke përmbushur nevojat e të gjithë nxënësve në klasë. | 2024-2026 | DKA, ZKKK | OJQ-të, Donatorët | 2<br>p |

| | |
|---|---|
| | **Nën-Totali 1.1** |

| **Rezultati 1.2** | **Ndërgjegjësohen palët e interesit për të ndihmuar arsimimin e pjesëtarëve të komuniteteve rom dhe ashkali** | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **Kodi** | **Aktiviteti** | **Përshkrimi i Aktivitetit** | **Periudha e implementimit** | **Përgjegjësia** | **Institucioni/organizata mbështetëse** |
| 1.2.1 | **Organizimi i fushatave vetëdijësuese për komunitetet rom dhe ashkali për rëndësinë e shkollimit** | ZKKK dhe DKA, në bashkëpunim me shkollat, si dhe me përkrahjen e OSHC-ve dhe donatorëve të ndryshëm organizojnë fushata vetëdijësuese për familjet e komuniteteve rom dhe ashkali. Fushatat mund të bëhen në formë të kampanjave të ndryshme mediale, takime formale dhe jo-formale, organizimin e tryezave të diskutimit etj.<br>Përveç fushatave informuese, këtu mund të përfshihen edhe studentë nga komunitet rom dhe ashkali apo edhe personalitete të suksesshme të cilat do ti tregonin storiet e tyre të suksesit përmes vizitave nëpër familje, apo edhe përmes organizimit të sesioneve të ndryshime informative.<br>Fushatat dhe sesionet informuese organizohen në prag të konkurseve të shpallura nga shkollat dhe institucionet tjera arsimore. | 2024-2026 | ZKKK, DKA | Shkollat, OSHC-të, Donatorët |
| 1.2.2 | **Organizimi i aktiviteteve të përbashkëta prind-komunitet-shkollë** | ZKKK, DKA, DKRS në bashkëpunim edhe me shkollat, si dhe me përkrahjen e OSHC-ve dhe donatorëve të ndryshëm organizojnë Aktivitete për fëmijët dhe prindërit e komuniteteve rom dhe ashkali, me qëllim të motivimit të nxënësve dhe prindërve për përfshirjen ne arsim.<br>Aktivitetet organizohen gjatë periudhës kur janë afatet për regjistrim në shkollë fillore dhe të mesme të lartë apo edhe duke shënuar Festat dhe Ditët e ndryshme Ndërkombëtare (p.sh. 1 Qershori - Dita e | 2024-2026 | DKA, ZKKK, DKRS, OJQ-të | Shkollat, Donatorët |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 1.3.1 | **Identifikohen dhe adresohen rastet e fëmijëve të ri-atdhesuar** | ZKKK në bashkëpunim me sektorët tjerë në nivel komune, identifikon familjet e ri-atdhesuara të cilat kanë fëmijë të moshës shkollore. Pas identifikimit, ZKKK ndërmerr të gjithë hapat për të adresuar në mënyrën më të mirë nevojat e këtyre familjeve. ZKKK krahas përkrahjes që ofron në kuadër të politikave të ri-atdhesimit, do të ofrojë edhe përkrahje shtesë për fëmijët e moshës shkollore p.sh. përkrahje për t'u pajisur me dokumentacionin përkatës, përkrahje për të nostrifikuar dokumentet. Kjo përkrahje nënkupton mbulimin e shpenzimeve financiare për këto shërbime dhe për vajtje-ardhje në MASHT/Prishtinë. Supozohet që brenda një viti mund të ketë 10 raste të tilla. | 2024-2026 | ZKKK | DKA, OJQ-të dhe donatorët |
| | | | | **Nën-Totali 1.3** | |

| Kodi | Aktiviteti | Përshkrimi i Aktivitetit | Periudha e implementimit | Përgjegjësia | Institucioni/organizata mbështetëse |
|---|---|---|---|---|---|
| 2.1.1 | **Fushatë informuese dhe avokuese për respektim të kuotës së punësimit për komunitetet** | ZKKK në bashkëpunim me Zyrën e Punësimit si dhe me përkrahjen e OSHC-ve dhe donatorëve të ndryshëm organizojnë fushatë avokuese në nivel komunal për të avancuar zbatimin e kuotës së punësimit për komunitetet rom dhe ashkali.<br>Kjo fushatë do të koordinohet nga ZKKK dhe ka për qëllim informimin e të gjitha institucioneve në nivel komune, bizneseve, punëdhënësve potencial, por edhe publikut në përgjithësi për kuotat e përcaktuara me ligj për punësimin e pjesëtarëve të komuniteteve.<br>Pjesë integrale e këtsaj fushate do të jetë edhe Inspektorati i Punës, të cilët do të informonin të punësuarit për dëmet dhe pasojat e ekonomisë informale. | 2024-2026 | ZKKK, Zyra e punësimit | OSHC-të, Donatorët |
| 2.1.2 | **Identifikimi i fuqisë punëtore nga komunitetet ashkali dhe rom (i të papunëve dhe punëkërkuesve) dhe ofrimi i këshillave për punësim** | ZKKK në bashkëpunim me Zyrën e Punësimit bënë identifikimin e fuqisë punëtore nga komunitetet ashkali dhe rom (i të papunëve dhe punëkërkuesve) dhe harton një databazë. Në bazë të nevojës harton plane përkrahëse këshilluese. ZKKK ndërmjetëson në raste të ndryshme me qëllim të rritjes së punësimit të përfaqësuesve të komuniteteve. | 2024-2026 | ZKKK, Zyra e punësimit | OSHC-të, Donatorët |
| 2.1.3 | **Ofrimi i kurseve shtesë për aftësim profesional dhe kurseve artizanale për punëkërkuesit nga komunitetet** | ZKKK në bashkëpunim me Zyrën e Punësimit bënë identifikimin e të gjithë punëkërkuesve nga komunitetet rom dhe ashkali. Në koordinim të ngushtë me Qendrat për Aftësim Profesional, duke u bazuar në nevojat e punëkërkuesve nga komunitetet rom dhe ashkali, harton plane për përfshirjen në kurse për aftësim profesional.<br>Në rastet kur kurset që kërkohen (sidomos ato artizanale) ZKKK dhe Zyra e punësimit mund | 2024-2026 | Komuna | OSHC-të, Donatorët |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | **të hapur biznese të reja** | komuniteti i donatorëve është i interesuar për të përkrahur krijimin e bizneseve të reja. Komuna do të shfrytëzoj këto mundësi duke participuar me mjete vetanake në nisma të tilla. | | | |
| | | | | **Nën-Totali 2.1** | |
| **Rezultati 2.2** | **Përmirësohet pjesëmarrja në skemat sociale e familjeve në nevojë nga komunitetet rom dhe ashkali** | | | | |
| **Kodi** | **Aktiviteti** | **Përshkrimi i Aktivitetit** | **Periudha e implementimit** | **Përgjegjësia** | **Institucioni/organizata mbështetëse** |
| **2.2.1** | **Identifikimi dhe vlerësimi i nevojave të familjeve në nevojë për përfshirje në skemat sociale** | Në Komunën e Shtimes ka pasur raste, kur familjet në nevojë për shkak të neglizhencës kanë humbur asistencën sociale, apo nuk janë fare përfitues të skemave sociale. Kjo ka ardhur si pasojë e mos-informimit të familjeve me kushtet, procedurat dhe kriteret për të qenë përfitues i skemave sociale. Për të shmangur situata të tilla, ZKKK, DShMS dhe QPS në bashkëpunim me OSHC-të identifikojnë nevojat e të gjitha familjeve nga komunitetet ashkali dhe rom që kanë nevojë për tu përfshirë në skema sociale. Sipas nevojave të identifikuara, DSHMS dhe QPS do të ndërmarrë të gjithë hapat e nevojshëm për ti përfshirë në skemat sociale familjet në nevojë. Theks i veçantë do ti kushtohet familjeve që kanë fëmijë me aftësi të kuafizuar. | 2024-2026 | ZKKK, DSHMS | QPS, OSHC-të, Donatorët |
| **2.2.2** | **Parandalimi i punëve të rënda dhe mbrojtja e fëmijëve të komuniteteve rom dhe ashkali** | Rastet e shumta të shfrytëzimit të fëmijëve qoftë për punë të rënda apo edhe shfrytëzimit të tyre për të kërkuar lëmoshë, obligojnë institucionet lokale që të zbatojnë masa për parandalimin e keqpërdorimit të fëmijëve. ZKKK do të ketë rol monitorues dhe mobilizues për të njoftuar institucionet dhe mekanizmat tjerë, në mënyrë që të parandalohet çdo keqpërdorim i fëmijëve të komuniteteve [illegible] | 2024-2026 | ZKKK, DSHMS | OSHC-të, Donatorët |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | **komuniteteve rom dhe ashkali në punësim dhe shërbime sociale** | (koordinator), DSHMS, QPS, Zyra e punësimit, DKA, OJQ-të, bizneset etj. Varësisht nga nevojat, ky mekanizëm mund të zgjerohet edhe me përfaqësues nga palët me interes. | | | OSHC-të, Donatorët |
| 2.2.4 | **Organizim i takimeve periodike për koordinim në mes të sektorëve** | ZKKK si koordinatore e Grupit koordinues do të organizojë takime periodike (2 herë në vit) për të siguruar që janë ndërmarrë të gjithë hapat e nevojshëm për të avancuar qasjen e pjesëtarëve të komuniteteve rom dhe ashkali në punësim dhe shërbime sociale.<br>Varësisht nga nevoja, ky Grup mund të takohet edhe më shpesh për të trajtuar çështjet dhe sfidat që paraqiten. | 2024-2026 | ZKKK | DSHMS, QPS, DKA, Zyra e Punësimit, OShC-të, Donatorët |
| | | | | **Nën-Totali 2.2** | |

**Fusha:** SHËNDETËSIA

**Objektivi 3:** **Përmirësimi i gjendjes shëndetësore dhe cilësisë së jetës te pjesëtarët e komuniteteve rom dhe ashkali**

**Rezultati 3.1** **Përmirësohet qasja në shërbime shëndetësore për pjesëtarët e komuniteteve rom dhe ashkali**

| Kodi | Aktiviteti | Përshkrimi i Aktivitetit | Periudha e implementimit | Përgjegjësia | Institucioni/organizata mbështetëse |
|---|---|---|---|---|---|
| 3.1.1 | **Organizimi i vizitave periodike shëndetësore ne familjet e komuniteteve nga QKMF** | Rritja e besueshmërisë së familjeve të komuniteteve, veçmas fëmijëve, në raport me institucionet shëndetësore dhe familjarizimi me to, do të ndikonte në ngritjen e vetëdijes së pjesëtarëve të komuniteteve për të shfrytëzuar këto shërbime.<br>QKMF me përkrahjen e DSHMS dhe ZKKK, organizon vizita periodike në familjet e komuniteteve rom dhe ashkali. Qëllimi i vizitave do të jetë ofrimi i shërbimeve shëndetësore për të gjithë | 2024-2026 | QKMF / QMF | DSHMS, ZKKK |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | imunizuar dhe imunizimi i tyre | bëhet imunizimi i tyre.<br>Ky aktivitet mund të organizohet në bashkëpunim me Qendrat e Komuniteteve (aty ku ekzistojnë), OJQ-të apo edhe me institucionet arsimore. | | QKMF / QMF | |
| 3.1.3 | **Ndarja e buxhetit për trajtimin e rasteve shëndetësore nga komunitetet** | Shërbimet që ofrohen nga QKMF dhe QMF shpeshherë nuk i përmbushin nevojat e pacienteve, veçmas kur paraqiten raste më të rënda të cilat kanë nevojë për një tretman më të veçantë. Praktikat e mëhershme nga Komuna e Shtimes, tregojnë se në disa raste Komuna ka ndihmuar financiarisht trajtimin e këtyre rasteve. Duke u bazuar në supozimin që pjesëtarët e komuniteteve rom dhe ashkali janë më të predispozuar ndaj këtyre rasteve, nevojitet një fond i paracaktuar për të ndihmuar këto raste.<br>ZKKK do të ketë rol koordinues në identifikimin e këtyre rasteve, apo do të jetë adresë për të kërkuar ndihmën e tillë.<br>Ndërsa, mjetet për trajtimin e këtyre rasteve do të ndahet direkt nga Komuna. | 2024-2026 | Komuna | ZKKK, DSHMS |
| | | | | **Nën-Totali 3.1** | |

| **Rezultati 3.2** | **Sigurohet një mjedis i shëndetshëm për popullsinë e komuniteteve rom dhe ashkali** | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **Kodi** | **Aktiviteti** | **Përshkrimi i Aktivitetit** | **Periudha e implementimit** | **Përgjegjësia** | **Institucioni/organizata mbështetëse** |
| | **Organizimi i ligjëratave rreth** | DSHMS në bashkëpunim të ngushtë QKMF dhe QMF duhet të organizojnë ligjërata të strukturuara rreth edukimit | | DSHMS, | |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 3.2.2 | **Organizimi i fushatave vetëdijësuese për shërbimet që ofrojnë QMF** | me OSHC-të, duhet të organizojnë fushata vetëdijësuese, ku target do të jenë familjet nga komunitetet rom dhe ashkali, me qëllim të informimit të tyre për shërbimet që ofrohen në QMF. | 2024-2026 | DSHMS, QKMF / QMF, ZKKK | OSHC-të, Donatorët |
| 3.2.3 | **Organizimi i vizitave periodike për mamografi – ne koordinim me ZKKK** | DSHMS në bashkëpunim me ZKKK dhe MSh/QKUK organizojnë vizita periodike për mamografi. Kjo mund të realizohet duke i organizuar këto vizita në QKMF apo edhe duke i organizuar vizitat në komunitet përmes Mamografit Mobil që menaxhohet nga MSH. | 2024-2026 | ZKKK, DSHMS | QKUK, MSh |
| | | | | **Nën-Totali 3.2** | |

| Kodi | Aktiviteti | Përshkrimi i Aktivitetit | Periudha e implementimit | Përgjegjësia | Institucioni/organizata mbështetëse | I |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 4.1.1 | **Hartimi i databazës së familjeve të pastrehë / familjeve në nevojë për banim** | ZKKK në bashkëpunim me Komitetin për Komunitete dhe në koordinim me përfaqësuesit e komuniteteve rom dhe ashkali bënë identifikimin e të gjitha familjeve të pastrehë apo që kanë nevojë për banim..<br>Të dhënat e detajuara për secilën familje do të futen në një databazë e cila do të shfrytëzohet edhe nga institucione tjera komunale. Hartimi i kësaj databaze duhet të jetë një proces i vazhdueshëm për shkak të lëvizjeve të mëdha që ndodhin, më konkretisht, për shkak të ndërrimit të vendbanimeve nga familjet, ri-atdhesimin e familjeve, apo për shkak të paraqitjes së rasteve të reja për banim. | 2024-2026 | ZKKK | DSHMS, OJQ | |
| 4.1.2 | **Zbatimi i kritereve për përfituesit e mundshëm / për ndërtim apo renovim të shtëpisë sipas Programit trevjeçar të banimit** | ZKKK në koordinim me donatorët dhe me përgjegjësit do të përkujdeset që Programi trevjeçar i banimit të zbatohet dhe të shfrytëzohen kriteret që burojnë nga ky program për përzgjedhjen e përfituesve të ndërtimit/renovimit të shtëpive për nevojtarët | 2024-2026 | Komuna | OSHC-të, Donatorët | |
| 4.1.3 | **Monitorim i vazhdueshëm i procesit të shpalljes së përfituesve të objekteve të banimit apo renovimit të shtëpive ekzistuese** | Komuna në bashkëpunim me ZKKK do të përkujdesen që procesi i ndarjes së banesave / përcaktimit të përfituesve potencial do të jetë proces transparent.<br>OSHC-të do të kenë rol monitorues gjatë gjithë procesit, ndërsa dokumentet e prodhuara nga ky proces duhet të jenë të qasshme për të gjithë të interesuarit.<br>Pas procesit të ndarjes së banesave / përcaktimit të përfituesve potencial për renovim, Komuna duhet të hartoj një raport përmbledhës i cili do të jetë në dispozicion për publikun. | 2024-2026 | Komuna, ZKKK | OSHC-të, Donatorët | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 4.2.1 | **Organizimi i takimeve avokuese për të adresuar problemin e banimit për komunitetet në veçanti të rikthyerit – Rëndesia e themelimit të Fondit Emergjent** | Përfaqësuesit e ZKKK zhvillojnë një plan të takimeve me Kabinetin e Kryetarit dhe me asambleistës për të adresuar problemin e banimit për komunitetet e në veçanti për rastet e rikthyer apo rastet që nuk e kanë të zgjidhur këtë problem. Takimet do të kenë karakter avokues, në mënyrë që të shtyhet përpara Themelimi i Fondit Emergjent për rastet e banimit. Ndretimi i shtepive. | 2024-2026 | ZKKK | Kryetari i Komunës, OSHC-të, Donatorët | |
| 4.2.2 | **Hartimi i dokumentacionit përcjellës për themelimin e Fondit** | ZKKK merr rol kryesor në hartimin e dokumentacionit për themelimin e Fondit Emergjent për rastet e banimit. ZKKK me përkrahjen e kabinetit të kryetarit caktojnë grupin punues për të hartuar dokumentacionin përcjellës për themelimin e këtij Fondi. Dokumenti kryesor që duhet të hartohet është: Akti i Themelimit - Statuti; ku do të përfshihen këto informata:<br>- Mënyra e shfrytëzimit te Fondit<br>- Rastet kur mund të shfrytëzohet Fondi<br>- Kriteret për përfituesit nga ky Fond<br>- Caktimi i mekanizmit në nivel komunal për menaxhimin e Fondit<br>- Shfrytëzimi i Fondit për bashkëfinancim i projekteve te donatorëve etj. | 2024-2026 | ZKKK | Kryetari i Komunës, OSHC-të, Donatorët | d ... 3 |
| 4.2.3 | **Takime periodike me donatorët potencial që do të kontribuonin në Fondin Emergjent për Banim** | ZKKK në koordinim me Kryetarin e Komunës organizon konferencë të donatorëve një herë në vit me qëllim të informimit për ekzistimin e një Fondi të tillë dhe mundësisë së gjetjes së mënyrave të bashkëpunimit / bashkëfinancimit të projekteve të ndryshme që kanë për qëllim zgjidhjen e problemit të banimit për rastet në nevojë. | 2024-2026 | ZKKK | Kryetari i Komunës, OSHC-të, Donatorët | S K e 2 |
| | | | **Nën-Totali 4.2** | | | |

| Rezultati 5.1 | Avancim i ndjeshëm drejt zgjidhjes së problemit të diskriminimit ndaj pjesëtar[ve të komuniteteve rom dhe ashkali | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Kodi | Aktiviteti | Përshkrimi i Aktivitetit | Periudha e implementimit | Përgjegjësia | Institucioni/organizata mbështetëse | P |
| 5.1.1 | Identifikimi dhe vlerësimi në mënyrë periodike i nevojave për parandalimin e diskriminimit | Identifikimi dhe vlerësimi në mënyrë periodike i nevojave për aftësimin e nëpunësve civil të Komunës për ngritjen e kapaciteteve profesionale në fushën e parandalimit dhe luftimit të diskriminimit dhe diskriminimit ndaj pjesëtarëve të komuniteteve Rom dhe Ashkali | 2024-2026 | ZKKK | DA, DSHMS, OJQ | S |

Objektivi 5: Parandalimi dhe luftimi i diskriminimit, racizmit, gjuhës së urrejtjes, krimeve të urrejtjes, segregimit, paragjykimit, stereotipeve dhe bullizmit

**SHTOJCA 1**

Ky dokument është përgaditur me përkrahjen e Instuticioneve të Komunës së Shtimes dhe përfaqësuesëve nga organizata joqeveritare me eksperiencë në trajtimin e çështjeve lidhur me gjendjen e komuniteteve joshumicë. Përmbajtja e këtij dokumenti është përgjegjësi ekskluzive e hartuesve dhe në asnjë rrethanë, nuk duhet t'i atribuohet donatorit dhe organizatave implementuese.

**GRUPI PUNUES:**

1. Faruk Beqa-Nenkryetar,Kryesues i grupit punues.
2. Gentiana Mehmeti-Koordinatore e KKV-së
3. Yllka Fejzullahu – Drejtoreshë e Drejtorisë Komunale për Arsim;
4. Muharrem Asllani – Drejtor i Drejtorisë Komunale për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale;
5. Grejtalb Emini – Drejtor i Drejtorisë Komunale për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi;
6. Elfete Shabani – Ud. Për Komunitete dhe Kthim
7. Reshat Gashi – Zyrtari Komunal për të drejtat e njeriut dhe Zyrtar për Barazi Gjinore;
8. Fatmire Ferati – Zyrtare në DKRS,
9. Kimete Uka – Zyrtare Kryesore për Financa;
10. Muhamet Mehmeti – Përfaqësues i OJQ-së Balkan Sunflowers Kosova në Prishtinë;
11. Ergjan Mehmeti– Përfaqësues i OJQ-së Art Stars Union në Shtime;
12. Bajram Ilazi – Përfaqësues i OJQ-së VORAE në Graçanicë;
13. Arjeta Maliqi – Përfaqësuese e OJQ-së Bashkimi Rinor për Bashkëveprim në Shtime.

**Kryesuesi i Kuvendit**

v.v. **Adnan Ademi**

____________________

REPUBLIKA E KOSOVES

REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA SH'TIME

OPSTINA STIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME

Drejtoria per Prokurim Publik/ Direkcija za javne nabayke/ Directorate of Public Procurement

| | |
|---|---|
| Data/Datum/Date: | 19.04.2024 |
| Nr./Br./No | 03/01/041 |
| Për/Za/To: | Kuvendin Komunal - Shtime |
| Permes: | Kryetarit të Komunës së Shtimes, Qemajl, Aliu |
| Nga/Od/From: | Feride Rexhaj, UD e Dretorisë së Prokurimit Publik |
| Lënda/Predmet/Subject : | Infonmatë për aktivitetet e prokurimit |

Drejtoria e Prokurimit në bashkëpunim me Zyrën e Financave dhe njësitë kërkuese si Dreitoritë,QKMF-në, QPS-në, SHKSH-në, Shkollat, kanë hartuar Planin Përfundimtar të Prokurimit 2024.

Plani Përfundimtar i Prokurimit 2024 është derguar në KRPP dhe AQP, sipas afateve ligjore, po ashtu ky plan i është dërguar të githa njësive kërkuese dhe është publikuar në faqen zyrtare të komunës.

Drejtoria e Prokurimit Publik gjatë përiudhës 01.01.2024 deri më datë 19.04.2024 ka udhëhequr dhe ekzekutuar procedura të prokurimit të parapara në Planin e Buxhetit dhe Planin Përfundimtar të Prokurimit, po ashtu dhe aktivitete tjera sipas kërkesave dhe nevojave të njësive kërkuese dhe marreveshjeve me Ministrite perkatese.

Gjatë kësaj periudhe, Drejtoria e Prokurimit Publik ka udhëhequr procedura të prokurimit për Pune, Furnizim dhe Shërbime si dhe ka kryer dëtyra te tjera, si: përgatitja e lëndëve për pagesë, nxjerja e urdhër blerjeve, përgatitja e lëndëve për OE dhe palët e interesuara, etj.

## Përshkrimi përmbledhës i aktiviteteve të zhvillura gjatë periudhes 01.01.2024-19.04.2024

### Aktivitete e Publikuar

| Nr | Emërtimi | Vlera e parashikuar | Statusi |
| --- | --- | --- | --- |
| 1 | Furnizim mjeksore (kontratë kornizë 2 vjeqare ) | 156,000.00 | Publikuar |
| 2 | Transporti i pacientëve për Hemodializë | 38,938.00 | Publikuar |
| 3 | Renovimi i QPS-së | 10,000.00 | Publikuar |
| 4 | Mirëmbatja dhe riparimi i automjeteve për Institucionet e Komunës së Shtimës-Kontratë kornizë 24 muaj | 39,438.20 | Publikuar |
| 5 | Renovimi i aneks-objektit të Sh. Rrezidenciale | 15,000.00 | Publikuar |
| 6 | Rruga Mehdi Gorani dhe rrethrrotullimi në Shtime, Shtime | 499,999.99 | Publikuar |
| 7 | Mirëmbajtja e infrastruktures në Komunën e Shtimës ( kontratë korrnizë tre vjeqare) | 350,000.00 | Publikuar |
| 8 | Mirëmbajtja verore-( kositjs e barit)-Mirëmbatja e parqeve dhe hapsirave të gjelbruara Mirëmbajtja dhe pastrimi i qytetit | 200,000.00 | Publikuar |
| 9 | Rregullimi i shtratit te lumit Shtime-LOT-I 2,000,000.00 € LOT-II- 1,500,000.00 € LOT-III- 1,500,000.00 € | 5,000,000.00 | Publikuar |

| | | | |
|---|---|---|---|
| 10 | Rruga te parku i biznesit - Gllavicë, Shtime | 800,000.00 | Publikuar |
| 11 | Rehabilitimi i rrugëve urbane dhe ndërurbane të dëmtuara nga peshat e rënda rr. Wiliam Walker, rr. Anton Qeta, s. Qameria, rr Muhaxhera, rr. Shefket Muhadini, rr. Jashari, s. rr. Ali Tafa, rruga Hafir Bajrami | 1,200,000.00 | Publikuar |
| 12 | Rruga Godanc - Rashincë - Muzeqinë, Shtime | 900,000.00 | Publikuar |
| 13 | Rregullimi i trotuareve dhe ndriçimit publik në Rr. Cani , Rr. Haxhiu , Rr. Rexha - kanalizim,seg i Rr Ferizaji | 85,000.00 | Publikuar |
| 14 | Asfaltimi I rrugës 14 Dhjetori | 36,998.69 | Publikuar |
| 15 | Asfaltimi I rrugës 17 Shkurti | 57,987.89 | Publikuar |

**Aktivitete në vlersim**

| Nr. | Emërtimi | Statusi |
|---|---|---|
| 1 | Shërbime të interpretimit dhe përfaqësimit të jashtëm ligjor, për Komunen e Shtimes Ri-tenderim | Në vlerësim |
| 2 | Mirëmbajtja dhe servisimi i aparateve kundër zjarrit | Në vlerësim |
| 3 | Furnizimi me material, dhe mirëmbajtja e ndërtesave për institicionet e Komunës së Shtimes--Kontratë korrnizë për 24 muaj | Në vlerësim |

| | | |
|---|---|---|
| 4 | Blerja e Rrobalarses industriale për QKMF-në | Në vlerësim |
| 5 | Blerja e Gjenratorëve për QPS-në dhe SHMULAvdullah Shabani Carralevë | Në vlerësim |
| 6 | Furnizim me material stomatologjik dhe laboratorik për QKMF-në Shtime | Në vlerësim |
| 7 | Organizimi i manifestimeve të festave shtetërore dhe komunale në Shtime | Në vlerësim |
| 8 | Furnizim me material hixhenik,për institucionet e komunës së Shtimes | Në vlerësim |
| 9 | Furnizim për zyre për institucionet e Komunës së Shtimes | Në vlerësim |
| 10 | Furnizim me Llaptop dhe Kompjuter - marrëveshje Kornizë me AQP-në | Në vlerësim |

**Kontrata e nënshkruara -2024**

| Nr | Emërtimi | Vlera e kontraktune | Data e nënshkrimit |
|---|---|---|---|
| 1 | Furnizim me Oksigjen për QKMF-në në Shtime | 1,300.00 | 05.03.2024 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| 2 | Furnizim me balon 150L për rregullimin e shtypjes së ajrit të ngrohjes - SHFMU Skenderbeu Reqak | 174.00 | 21.02.2024 |
| 3 | Furnizim me buketa lulesh | 1,774.40 | 05.03.2024 |
| 4 | Shërbimet e Informimit Publik, Procedurë e Negociuar | 3,000.00 | 29.02.2024 |
| 5 | Furnizim për aktivitete te ndryshme (Dita e Mjedisit, Dita e Evropes,7 Marsi dhe festat të ndryshme) | 993.50 | 01.03.2024 |
| 6 | Kontrolli i rrezatimit të RTG-së dhe matja e dozimetrave të QKMF-së Dr,Vezir Bajrami Shtime | 480.00 | 01.03.2024 |
| 7 | Furnizim me drunj dekorativ dhe lule, për rregullimin e hapsirave publike dhe parqeve në institucionet e komunes së Shtimes | 18,365.95 | 05.04.2024 |
| 8 | Shërbime psikiatrike dhe shërbime fizioteparеutike për personat e SHKSH-së në Shtime | 747.50 | 05.04.2024 |
| 9 | Furinizim me ushqim dhe pije, me raste të organizimit, pregaditjes së koktejeve për festa në Komunen e Shtimes | 4,520.25 | 05.04.2024 |
| 10 | Shërbimet fotografike per aktivitete të zyres së Kryetarit | 4,359.00 | 05.04.2024 |
| 11 | Trajtimi i Qenve endacak në Komunen e Shtimës, vakcinimi, dehelmetizmi , matrikulimi dhe kastrim i tyre | 6,490.00 | 17.04.2024 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| 12 | Rregullimi i veturës për QPS-në në Shtime Ritenderim | 740.00 | 18.03.2024 |
| 13 | Furnizim mjekësorë(me reagensa dhe material për laborator) | 997.00 | 18.03.2024 |
| 14 | Hartimi dhe kontrollimi i testeve sipas lëndëve mësimore në garat Komunale të diturisë | 1,625.00 | 15.04.2024 |
| 15 | Furnizim me tepih dhe perde për institucionet e Komunës së Shtimes | 1,968.90 | 15.04.2024 |
| 16 | Asfaltimi i rrugëve dhe trotuarit në Davidoc Rr."Ibrahim Rugova", seg. Rr."Smajl Gorani", seg. i Rr."Emini", Rr." Baftiu", ndriçim në Rr."Sadriu", dhe në Rr."Zeqë Zeqiri " Ri-tenderim".( Punë Shtesë ) | 5,382.00 | 02.04.2024 |
| 17 | Rregullimi i rrugeve ndriqimit dhe kanalizimit ne Zborc rr. Hafir Bajrami , rr. Rifat Haliti -Ri-tenderim.( Punë Shtesë ) | 6,756.00 | 02.04.2024 |
| 18 | Asfaltimi i disa segmenteve të rrugëve, ndriçimit dhe kanalizimit në fshatin Pjetërshticë , Rr.Aziz Dugolli, Rr.Rrezja, Rr.Idriz Ajeti, Rr.Isak Brahimi, Rr. Shaqir Dugolli .( Punë Shtesë ) | 3,839.50 | 02.04.2024 |
| 19 | " Asfalltimi i rrugeve, ndricimit dhe trotuarit ne Gjyrkoc, seg i Rr. "Bushati", ndricim Rr. Pjetershtica" Rr. Kastrati"( Pune Shtese) | 4,887.10 | 02.04.2024 |
| 20 | "Afalltimi i rrugëve tretuarve dhe ndriçimit ne Rr. "Cani", rr. "Burimi" rr. "Ferizaj", rr. "Beqir Rushiti"rr. Trimat e Lirise", rr "Qorrolli( Punë Shtesë) | 6,617.90 | 02.04.2024 |
| 21 | Transport për gara të nxënësve në territorin e Kosovës | 495.00 | 12.04.2024 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| 22 | Furnizim me Veshëmbathje | 6,939.00 | 17.04.2024 |
| 23 | Shërbime të veqanta – "Artiktekt" Loto I-Ri tenderim | 5,196.00 | 26.02.2024 |
| 24 | Asfaltimi i rrugeve ne parkun e biznesit ne Gllavice | 100,000.00 | 16.02.2024 |
| 25 | Shërbim-vetur me qera | 999.00 | 18.04.2024 |

| Aktivitet e prokurimit për 2024 | | Procedura të zhvilluara | Urdhërblerje për pages janë; |
|---|---|---|---|
| Furnizim | 28 | 16 | 151 pagesa |
| Shërbim | 40 | 16 | |
| Punë | 45 | 18 | |
| | | | |
| Total; | 113 | 50 | |

| Marrërrveshje Bashkëpunimi për 2024; |
|---|
| 8 |

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/
REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA-SHTIME/OPŠTINA-ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SH

| | |
|---|---|
| Data/Datum/Date: | 19/04/2023 |
| Nr./Br./No | 04/12 |
| Për/Za/To: | Zyra e Kryetarit Kuvendit |
| Përmes/Preko/Through: | Drejtor për Zhvillim Ekonomik |
| Nga/Od/From: | Kastriot Shabani, Drejtor për Zhvillim Ekonomik |
| Lënda/Predmet/Subject : | Informate DZHE |

DREJTORIA PËR ZHVILLIM EKONOMIK

Planifikimi vjetor i veprimtarise së Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik për vitin 2023 bazohet në prioritetet zhvillimore te Komunës se Shtimes,kompetencat e drejtorisë bazuar në fushën strategjike të Zhvillim Ekonomik.

Në bazë te planit te punës të Drejtorisë kemi paraparë që gjatë këtij viti;

Të bëhet monitorimi i aktiviteteve dhe investimeve në Parkun teknologjik,monitorim për bizneset qe ushtrojnë veprimatarinë e tyre.

Zbatimi i procedurave për dhënien në shfrytezim të pronave komunale.

Bashkëpunimi me institutcione qeveritare dhe joqeveritare për perkrahjen e Zhvillimit Ekonomik.

Vazhdimi i punimeve në Parkun Teknologjik gjatë ketij viti ,asfaltimi i të gjitë rrugëve në mbrendësi te parkut si dhe lauren për funksionim sa me te mire dhe po ashtu Komuna të ofrojë kushte te mira për bizneset qe operojnë ne atë zonë.

Në Zonën Ekonomike Gllavice jemi ne pritje te Hartimit te PZHK-SE për marrjen e pelqimit te fundit që ka mbetur nga ministria e Bujqesisë që si kusht ka aprovimin e PZHK pastja dhenien e pëlqimit pasi aty kemi te bejmë me konvertim te tokës, prej tokës bujqësore ne tokë për ndërtim për biznese që do të veprojnë në atë zonë Ekonomike.

Këtë vit, po investojmë vlerën prej prej 100.000 euro prej Buxhetit komunal per infrastrukturë mbrenda Zonës Ekonomike dhe presim pas marrjes se statusit si Zone Ekonomike perkrahje nga MINT qe janë te destinuara per Zona Ekonomike.

Gjatë keti viti kemi parapa edhe Investime Kapitale

Po vazhdon rregullimi I kanaleve kulluese te ujrave atmosferik per tokat Bujqesore

Po ponohet në rregullimin e shtigjeve profesionale per ciklizem dhe MotoCross ne Zonat turistike Mullopolc Llanisht.

-Punët po vazhdojnë, punët e rrugës Idriz Seferi

- Po punohet rregullimi i parkut te pishat ne Shtime faza IV.

Kur jemi te investimet kapitale vlen te theksohet edhe hapat shume me rendesi qe kemi bërë per ngrohtoren e qytetit me biomas bashkë me CNVP-në dhe ekspertet austriak kemi perfunduar fizibilitetin e zgjeruar per ngrohtoren me biomasë.

Për kët vit jemi në perfundimim të proceduarave për:

Rruget me zhavor të fshatrave Mullopolc,Vojnoc,Recak,Petrovë,Gjyrkovc,Godanc,Muzeqinë,Rashincë Pjetershticë.

Shenjëzimin e pikave turistike në zonat kodrinomalore të komunës sonë.

Kanalizimi në zonën e biznesit në komunen e Shtimes.

Aprovimi I kerkesës per renovimin e Infrastruktures në Parkun Teknologjik në vlerë prej 300.000 euro.

Gjatë vitit 2024 do hapim një thirrje pës subvensionimin e bizneseve të vogla dhe të mesme që do të jetë ndihmë per bizneset ekzistuese si dhe start up.

## Struktura e biznseve në komunën e Shtimes

| Nr. | Aktivitetet | Meshkuj | Femra | Gjithsej bizneset e regjistruara | % | Numri i punetoreve |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | B - Bujqësia | 114 | 25 | 139 | 6.20 | 284 |
| 2 | C - Industria Perpunuese Prodhimtaria | 266 | 35 | 301 | 13.42 | 692 |
| 3 | D - Furnizimi me Rryme Gaz Avull dhe Klimatizim | 4 | 1 | 5 | 0.22 | 10 |
| 4 | E - Ujesjellesi Kanalizimi Menaxhimi i Mbeturinave dhe Aktivitetet e Riparimit | 3 | 1 | 4 | 0.18 | 4 |
| 5 | F - Ndertimtaria | 258 | 6 | 264 | 11.77 | 618 |
| 6 | G - Tregtia me Shumice dhe Pakice Riparimi i Mjeteve Motorike dhe Motocikletave | 679 | 70 | 749 | 33.39 | 1348 |
| 7 | H - Transporti dhe Magazinimi | 186 | 3 | 189 | 8.43 | 233 |
| 8 | I - Hoteleria dhe Akomodimi | 212 | 20 | 232 | 10.34 | 445 |
| 9 | J - Informimi dhe Komunikimi | 30 | 3 | 33 | 1.47 | 53 |
| 10 | K - Aktivitetet Financiare dhe te Sigurimit | 3 | 2 | 5 | 0.22 | 5 |
| 11 | L - Aktivitetet e Patundshmerise | 5 | 1 | 6 | 0.27 | 9 |
| 12 | M - Aktivitetet Profesionale Shkencore dhe Teknike | 41 | 9 | 50 | 2.23 | 90 |
| 13 | N - Aktivitetet Sherbyese dhe te Perkrahjes | 26 | 5 | 31 | 1.38 | 41 |
| 14 | P - Arsimi | 10 | 7 | 17 | 0.76 | 56 |
| 15 | Q - Aktivitetet e Shendetit Njerezor dhe te Punes Sociale | 32 | 7 | 39 | 1.74 | 71 |
| 16 | R - Artet Argetimi dhe Rekreacioni | 42 | 9 | 51 | 2.27 | 105 |
| 17 | S - Aktivitetet Tjera Sherbyese | 85 | 43 | 128 | 5.71 | 149 |
| | Gjithsej | 1,996.00 | 247.00 | 2,243.00 | 100.00 | 4,213.00 |

REPUBLIKA E KOSOVES - KOMUNA E SHTIMES - OPSTINA

Raport 03.01.2024 – 31.03.2024,

1. **Sektori për Zhvillim Ekonomik**

Tabela pasqyron aktivitetet e Zyrës për Regjistrimin e bizneseve

| Nr | Aktivitetet | Numri |
|---|---|---|
| 1 | Regjistrimi i bizneseve të reja | 35 |
| 2 | Shuarje të biznesit | 2 |
| 3 | Ndryshime në biznes (certifikata të biznesit) | 141 |
| 4 | Vërtetim për mos posedim të biznesit | 2 |
| 5 | Ndryshime në biznes (shtim veprimtarie) | 2 |
| 6 | Ndryshime ne biznes (shtim, heqje njësie) | 2 |
| 7 | Leje të përkohshme për zgjatjen e orarit të punës | 0 |
| 8 | Informata mbi Biznesin | 43 |
| 9 | Certifikata Duplikat | 0 |
| 10 | Ndërrim Pronari ose përfaqësuesi | 3 |

**REPUBLIKA E KOSOVËS**
**REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO**

**KOMUNA SHTIME**
**OPŠTINA ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME**
**Zyra e kryetarit/Kancelarija predsednika/Major's office**

| | |
|---|---|
| Data/Datum/Date: | 26.3.2024 |
| Nr./Br./No: | 02/229 |
| Për/Za/To: | Komisionin e ndarjes së titullit "Qytetar Nderi" |
| Nga/Od/From: | Kryetari i Komunës së Shtimes, z. Qemajl Aliu |
| Lënda/Predmet/Subject : | Propozim për zgjedhjen e personalitetit për titullin "Qytetar Nderi" |

Në mbështetje të nenit 4, pika 4.7 të Rregullores Nr. Npi-01/173 të dates 27.5.2009, Kryetari i Komunës propozon vlerësimin dhe rekomandimin Komisionit Komunal për ndarjen e titullit "Qytetar Nderi" i Komunës së Shtimes për personalitetin: z. Hartmut Ganzke.

## Arsyetim

Z. Hartmut Ganzke është deputet i njohur gjerman dhe personalitet i shquar politik që ka shërbyer në Kuvendin e Krahinës së Nordrhein-Westfalen si dhe njëkohësisht ka qenë Shef i Grupit Parlamentar të subjektit SPD në Qarkun Unna të Republikës Federale të Gjermanisë.

Z. Ganzke është autor i njohur i librave shkencorë me përmbajtje të fushës nga e drejta penale, fushë në të cilën përveçse i ka ndjekur studimet gjithashtu e ushtron profesionin e avokatit.

Z. Hartmut Ganzke lirshëm mund të konsiderohet mik i të gjithë popullit tonë për të cilin nuk ka reshtur së punuari në përmirësimin dhe avancimin e të drejtave në landin e Nordrhein-Westfalen si dhe përmes ndikimit të tij në subjektin SPD në të gjithë strukturën shtetërore të Republikës Federale të Gjermanisë, me në krye Kancelarin Olaf Scholz, që njihet për qasjen e plotë ndihmëse ndaj ne popullit shqiptar dhe për Republikën e Kosovës.

Z. Ganzke është një figurë e shquar edhe në skenën politike ndërkombëtare, i cili ka ndikuar thellë në promovimin e paqes, stabilitetit dhe bashkëpunimit rajonal duke ndihmuar personalisht komunitetin shqiptar në hapësirën ku vepron edhe sot e tutje,

falë të cilës ka pasur efekte konkrete pozitive për shqiptarët që jetojnë në regjionin e Nordrhein-Westfalen dhe jo vetëm.

Përmes angazhimeve të tij si deputet në Kuvendin e Nordrhein-Westfalen dhe nëpërmjet rolit të tij si diplomat, ai ka ndihmuar në tërheqjen e vëmendjes ndërkombëtare ndaj çështjeve të Kosovës dhe rajonit të Ballkanit Perëndimor.

Kontributi i tij në procesin e paqes dhe shtetndërtimit tonë dhe në përpjekjet për të ndërtuar ura të forta midis popujve dhe komunitetit gjerman dhe shqiptar duhet vlerësuar dhe respektuar gjerësisht në Kosovë, sidomos nga Komuna jonë që kemi pasur nderin përveçse ta kemi në vizitë, të jemi edhe përfitues nga nismat e bashkëpunimit dhe mbështetjes të cilat i ka sponzoruar z. Ganzke. Konkretisht, falë angazhimit të z. Ganzke, Komuna jonë është përfituese e një automjeti të bartjes së mbeturinave, një automjet të zjarrfikjes si dhe aktualisht jemi në përgatitje të shkëmbimit të sportistëve tanë jo vetëm për përballje miqësore, por edhe mësim nga afër me teknikat më të reja dhe të avancuara të trajnimeve sipas modelit gjerman të disa klubeve sportive atje, me ç'rast deputeti Ganzke ka dhënë dhe po vazhdon të jap përpjekje maksimale për realizimin sa më të mirë e më të shpejtë të këtyre çështjeve dobiprurëse për Komunën dhe qytetarët tanë.

Z. Hartmut Ganzke mbetet një mbështetës i palodhur i projekteve dhe iniciativave që kanë për synim të rrisin nivelin e arsimit, ngritjen e kapaciteteve sportive dhe të promovojnë zhvillimin ekonomik të Komunës së Shtimes. Përmes bashkëpunimit me institucione arsimore dhe organizata të ndryshme sportive, ai ka kontribuar në krijimin e mundësive të reja për të rinjtë e Komunës sonë, rezultate të cilat do të na bëjnë krenarë të gjithë ne qytetarëve të Shtimes dhe më gjerë.

Veprimet politike dhe institucionale të Ganzkes kanë ndihmuar në rritjen e resurseve vendore lokale për të ndërtuar një të ardhme më të ndritshme dhe më të sigurtë për qytetarët e Komunës së Shtimes.

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA SHTIME
OPŠTINA ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME
**Zyra e kryetarit/Kancelarija predsednika/Major's office**

Dhënia e titullit "Qytetar nderi" në vizitën e tij zyrtare që z. Ganzke ka planifikuar ta zhvillojë në muajin maj është një akt i përkushtimit të Komunës sonë për të vlerësuar dhe nderuar kontributet e individëve të jashtëzakonshëm në ndërtimin e një shoqërie më të mirë dhe më të drejtë për të gjithë.

Kjo shpallje për z. Ganzke nuk është vetëm një akt formal, por një shprehje e përkushtimit tonë për të avancuar vlerat e paqes, të arsimit, sportit, artit dhe kulturës si dhe të bashkëpunimit ndërkombëtar nëpërmjet respektimit dhe vlerësimit të atyre që kanë ndikuar pozitivisht në komunitetin tonë dhe përtej tij.

Prandaj, bazuar në veprimtarinë e gjatë mbështetëse të z. Ganzke për komunitetin shqiptar në përgjithësi dhe për Komunën e Shtimes në veçanti, kërkoj analizimin real të të gjitha dëshmive nga Komisioni që do të rezultojnë me rekomandim pozitiv që deputeti Hartmut Ganzke të votohet dhe të shpallet i denjë për ta fituar çmimin "Qytetar Nderi" i Komunës së Shtimes.

Adresa: Rr. Tiranës, 72000, Shtime, Republika e Kosovës.
Tel.: +381290389016, email: info.shtime@rks-gov.net
http://kk.rks-gov.net/shtime

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA SHTIME
OPŠTINA ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME

**Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale**
**Uprava za Zdravstvo i Socialnu Zastitu/Department of Health and Social Velfare**

| | |
|---|---|
| Data/Datum/Date: | 17.04.2024 |
| Nr./Br./No | 07/128 |
| Për/Za/To: | Kuvendin e Komunës së Shtimes |
| Nga/Od/From: | Muharrem Asllani,Drejtor i Shëndetësisë dhe Mirëqenie Sociale |
| Lënda/Predmet/Subject : | INFORMATË |

PËRMBAJTJA

I. **Drejtoria Komunale e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale**
**Puna dhe aktivitetet e rregullta**

II. **Sektori i Shëndetësisë të Kujdesit Primar Shëndetësor :**

**Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare " Dr Vezir Bajrami"**

III . **Sektori i Shërbimeve Sociale :**

**Qendra për Punë Sociale**

IV. **Shërbimet Rezidenciale – Institucionale :**

**Shtëpia e Komunitetit për Persona me aftësi të Kufizuar Mendore**

Në këtë raport, janë përfshirë aktivitetet e Drejtorisë Komunale të Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale për periudhën **Janar - Prill 2024**. Këto aktivitete përfshijnë sektorët e shëndetësisë, shërbimeve sociale dhe shërbimeve rezidenciale-institucionale.

1. **Drejtoria Komunale e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale:**
   - **Puna dhe aktivitetet e rregullta:** Kjo drejtori ka realizuar planet e parapara sipas kalendarit të tyre. Për shembull, janë pranuar 192 kërkesa, ku 111 prej tyre janë për nënat lehona për fëmijët e lindur gjatë vitit 2023-2024. Gjithashtu, janë bërë hapje të thirrjeve publike për aplikimin e OJQ-ve.
   - **Aktvendimet për vazhdimin e qëndrimit të rezidentëve në Qendrën Rezidenciale:** Është përpiluar aktvendime për vazhdimin e qëndrimit të rezidentëve në Shtëpinë e Komunitetit për persona me aftësi të kufizuar mendore.

2. **Sektori i Shëndetësisë të Kujdesit Primar Shëndetësor: Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare "Dr. Vezir Bajrami":** Raporti përmban informacion mbi vizitat mjekësore në këtë qendër. Për shembull, janë realizuar 12,049 vizita mjekësore dhe 13,413 vizita urgjence. Gjithsej janë ofruar 10,963 shërbime urgjence.

Gjatë periudhës **Janar – Prill 2024**, janë kryer keto aktivitete në sektorin e shëndetësisë dhe të shërbimeve sociale.

1. **Sektori i Shëndetësisë:**
   - **Shërbimet në Mjekësi Familjare (QMF):** Gjithsej janë ofruar **12,049 vizita mjekësore** dhe **10,963 vizita urgjence**. Përveç kësaj, janë ofruar shërbime në stomatologji, barnatore, radiologji, laborator, dhe kujdes paliativ.
   - **Aktivitete shëndetësore të tjera:** Këto përfshijnë vizita sistematike në shkolla, fushata të vaksinimit, dhe organizimin e ceremonive për pensionim të personelit.
2. **Zyra e Prokurimit:**
   - Janë realizuar **22 aktivitete të prokurimit** për furnizim me oksigjen, lule dhe drunje dekorativ, pajisje teknologjike, kompjuterë, barna, materiale stomatologjike, reagjensa për laborator, etj.
3. **Zyra e Personelit:**
   - Janë realizuar **52 aktivitete nga zyra e personelit**, përfshirë mbledhjet e Këshillit Drejtues, konkurset, lidhjen e kontratave, përgjigje në kërkesa dhe ankesa, vërtetime, vërejtje, dhe ndalesa administrative.

3.Sektori i Shërbimeve Sociale:

**Qendra për Punë Sociale**: Prioriteti kryesor është raportimi dhe përcjellja e shpenzimeve të destinuara për QPS nga buxheti i konsoliduar i Kosovës. Shpenzimet për komunalitete janë gjithashtu monitoruar për muajin Shkurt 2024.

4. **Shtëpia e Komunitetit për Persona me aftësi të Kufizuar Mendore në Shtime :**

**Shtëpia e Komunitetit për Persona me aftësi të Kufizuar Mendore** ka ofruar një gamë të gjerë shërbimesh dhe aktivitetesh për klientët e saj gjatë periudhës **Janar - Prill 2024**. Ja disa nga pikat kryesore:

- **Shërbimet e ofruara**: Stafi prej 13 personave ka ofruar kujdes 24 orë në ditë, duke përfshirë plotësimin e nevojave ushqimore, higjenike dhe shëndetësore të klientëve.
- **Aktivitetet me klientët**: Përfshijnë aktivitete festive, fizike, sociale, edukativo-arsimore, vizita në institucione rekreative dhe ekskursione.
- **Aktivitetet e stafit**: Mbledhje ditore dhe javore për organizimin e shërbimeve, si dhe angazhim në aktivitete të ndryshme me klientët.
- **Gjendja shëndetësore e klientëve**: Është mbajtur nën monitorim të vazhdueshëm, me vizita të rregullta mjekësore dhe specialistike.

Gjithashtu, Shtëpia e Komunitetit ka treguar solidaritet ndaj institucioneve të tjera, si në rastin e dhënies së 2 ton pelet në formë hua për çerdhjen "Albiona Asllani" dhe shpërndarjen e ushqimit për qytetarin Hajdin Asllani.

**Vizitat dhe monitorimet:**

- **Vizita nga KFOR-i**: Një ekip ushtarak dhe shëndetësor i kontigjentit Turk ka vizituar qendrën, ku janë informuar për kushtet e jetesës dhe kanë premtuar mbështetje.
- **Donacione nga Kisha Katolike**: Është bërë dhurimi i rrobave të përdorura për rezidentët, me disa pako që janë dërguar në zyrën e Kryqit të Kuq në Shtime për shkak të papërshtatshmërisë.

- Janë realizuar **12 vizita familjare** dhe **11 vizita të klientëve në familje**, dhe institucioni ka qenë i furnizuar mirë me ushqim.
- **Kërkesat dhe Donacionet**: Është bërë kërkesë për furnizim me një veturë për nevoja sociale dhe aktivitete në natyrë, dhe janë pranuar donacione nga Kisha Katolike.

- **Trajnimet e Stafit:** Ka një nevojë për trajnime të mëtejshme për stafin për të ofruar shërbime më cilësore dhe profesionale.
- **Vështirësitë dhe Defektet:** Probleme me ujrat atmosferike dhe kërkesa për ndihmë nga drejtoritë e Shërbimeve Publike dhe Infrastrukturës.
- **Synimet:** Përmirësimi i shërbimeve dhe ambientit për klientët në koordinim me DSHMS dhe me ndihmën e donatorëve potencial.
- **Të Arriturat:** Oferta e kushteve optimale të banimit dhe organizimi i aktiviteteve psiko-sociale për mirëqenien e banorëve rezident.

**Stafi i Punëtorëve:**

- **Stafi:** Përbëhet nga nëntë punëtorë të rregullt dhe katër të kontraktuar nga Caritas Kosova, duke përfshirë infermierë, ndihmës mjekësorë dhe pastrues.

**Struktura Momentale e Rezidentëve:**

- **Nacionaliteti:** 10 shqiptarë (5 femra, 5 meshkuj) dhe 1 musliman.

**Republika e Kosovës**
Republika Kosova – Republic of Kosovo
*Qeveria – Vlada – Government*
Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
Ministarstvo za Finansije, Rada i Transfera - Ministry of Finance, Labour and Transfers
Thesari i Kosovës – Trezor Kosova - Treasury of Kosovo

# PAGESË RETROAKTIVE

*Të plotësohet nga nëpunësi i autorizuar* **TH/SP/F04**

**Të dhënat për institucionin**

| Institucioni | Departamenti/Drejtoria |
|---|---|
| KOMUNA SHTIME | Zyra e Kuvendit Komunal |

| Divizioni/Sektori | Kodi (org.) | Kodi Buxhetor |
|---|---|---|
| Zyra e Kuvendit Komunal | 617 | 10-617-16907-0111 |

**Të dhënat personale**

| Emri | Mbiemri | Nr. i Letërnjoftimit | Nr. i nëpunësit në SP |
|---|---|---|---|
| BESNIK | SEFERI | 1232296727 | EM00147833 |

**Të dhënat për pagën**

| Pozita e punës | Kodi | Data e fillimit të punës | Orët e punës |
|---|---|---|---|
| Anëtar/e i/e Kuvendit Komunal i Komunës 5 | | | |

| Emërtimi i pozitës (Ligji i pagave) | Kodi në SP | Klasa | Koeficienti | Paga bazë |
|---|---|---|---|---|
| Anëtar/e i/e Kuvendit Komunal i Komunës 5 | (37-CD_7( | 5.50 | 5.50 | 577.50 |

**Të dhënat për pagesën retroaktive**

| | |
|---|---|
| Periudha | QERSHOR |
| Shuma | 181.50 |

**Të dhënat Bankare**

| | |
|---|---|
| Emri i bankës | RAIFFEJZEN BANK |
| Nr. i llogarisë | 1504040000652202 |

Arsyeja: KOPENZIM I MUAJIT QERSHOR

**Aprovuar nga:**

| | Emri dhe mbiemri | Data e shqyrtimit | Nënshkrimi |
|---|---|---|---|
| Nëpunësi i Autorizuar | NAIM HASANI | 03/07/2024 | |
| Nëpunësi Aprovues/ZKF | KIMETE UKAJ | 03/07/2024 | |

| Koment nga Thesari: | |
|---|---|